



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E FINANCAVE – MINISTARSTVO FINANSIJE – MINISTRY OF FINANCE



NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE

RAPORTI VJETOR 2016



**NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE
FINANSIJSKA OBAVEŠTAJNA JEDINICA
FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT**

RAPORTI VJETOR 2016

PËRMBAJTJA

| | |
|---|-----------|
| 1. HYRJA | 7 |
| 2. ORGANIZIMI I NJIF KOSOVA | 8 |
| 2.1. Historiku i NJIF-K | 8 |
| 2.2. Detyrat | 9 |
| 2.3. Buxheti dhe Prokurimi | 10 |
| 2.3.1. Buxheti..... | 10 |
| 2.3.2. Aktivitetet e Prokurimit..... | 10 |
| 2.4. Organizimi i NJIF-K | 11 |
| 2.4.1. Mbikëqyrja e NJIF-K..... | 11 |
| 2.4.2. Burimet njerëzore dhe Struktura organizative e NJIF-K..... | 12 |
| 3. ZHVILLIMET LIGJORE PËR PPP/LFT | 14 |
| 3.1. Zhvillimi i kornizës ligjore | 14 |
| 3.2. Aktet nënligjore | 17 |
| 3.2.1. Udhëzimet Administrative, Rregulloret dhe Procedurat Standarde të Veprimit..... | 17 |
| 4. PERFORMANCA E NJIF KOSOVË | 18 |
| 4.1. Pranimi, analizimi dhe shpërndarja e inteligjencës financiare | 18 |
| 4.1.1. Të dhënat dhe raportet e proceduara..... | 18 |
| 1.1. 20 | |
| 4.1.2. Raportimi i Transaksioneve të Dyshimta..... | 20 |
| 4.1.2.1. <i>Raportimi i Transaksioneve të Dyshimta 2011-2016</i> | 22 |
| 4.1.3. Transaksionet e dyshimta për Financim të Terrorizmit..... | 25 |
| 4.1.4. Raportimi i Transaksioneve në para të gatshme (RTG)..... | 26 |
| 4.1.5. Raportimi i transaksioneve jo të zakonshme (Monitorimi special i transaksioneve të veçanta)..... | 28 |
| 4.1.6. Raportimi i Deklarimit Kufitar (Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës)..... | 29 |
| 4.1.7. Ngrirja e transaksioneve bankare..... | 30 |
| 4.1.8. Kërkesat e OJQ-ve për përjashtim nga ndalesat ligjore..... | 31 |
| 4.1.9. Analizimi i raporteve të inteligjencës..... | 31 |
| 4.1.10. Hapja e rasteve me iniciativë të NJIF-K..... | 32 |
| 4.1.11. Shpërndarja e raporteve të inteligjencës..... | 33 |
| 4.1.12. Kërkesat për informata nga institucionet vendore dhe homologët ndërkombëtar..... | 36 |
| 4.2. Mbikëqyrja e Pajtueshmërisë | 37 |
| 4.2.1. Ndëshkimet administrative dhe masat për përmirësim..... | 40 |
| 4.2.2. Të dhënat statistikore dhe informatat kthyesë..... | 42 |
| 4.3. Aktivitetet e trajnimeve dhe implementimi i Programit të Trajnimeve | 43 |
| 4.4. Aktivitetet e ngritjes së vetëdijes | 44 |
| 4.5. Ngritja e kapaciteteve të NJIF-K | 46 |
| 4.5.1. Teknologjia Informative..... | 46 |
| 4.5.2. Trajnime, konferenca, seminare dhe takime tjera të ndjekura nga personeli i NJIF-K..... | 47 |
| 5. BASHKËPUNIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR | 52 |
| 5.1. Bashkëpunimi dhe koordinimi vendor | 52 |
| 5.1.1. Bashkëpunimi me Agjensionet e Zbatimit të Ligjit dhe institucionet tjera..... | 53 |
| 5.2. Bashkëpunimi me homologët e huaj dhe Grupin Egmont | 55 |
| 5.2.1. Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve..... | 55 |
| 5.2.1.1. <i>Kërkesat e pranuar dhe shpërndara për shkëmbim të informacionit ndërkombëtar</i> | 55 |

| | |
|---|-----------|
| 5.2.1.2. Kërkesat e NJIF-K drejtuar FIU ndërkombëtare për shkëmbim të informacionit ndërkombëtar | 57 |
| 5.2.1.3. Shkëmbimi në kohë dhe konstruktiv i informacionit | 59 |
| 5.2.1.4. Ndarja Spontane e Informacionit me FIU Ndërkombëtare | 59 |
| 5.2.2. Bashkëpunimi regjional..... | 60 |
| 5.2.3. Memorandumet e Mirëkuptimit | 61 |
| 5.2.4. Procesi i Anëtarësimit në organizata ndërkombëtare | 61 |
| 5.2.4.1. Grupi Egmont..... | 61 |
| 6. MENAXHIMI I RREZIKUT NË PASTRIM TË PARAVE DHE FINANCIM TË TERRORIZMIT | 63 |
| 6.1. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit 2014-2018..... | 63 |
| 7. MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE | 65 |
| 7.1. Projektet e financuar nga BE-ja&KiE | 65 |
| 7.1.1. Projekti i BE&KiE “Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë - Faza II (PECK II)” | 65 |
| 7.1.2. Projekti i KiE&BE "iPROCEEDS" | 66 |
| 7.2. Mbështetja nga UNDP | 66 |
| 8. PLANI I PERFORMANCËS DHE RESURSEVE TË NJIF-K 2015-2017..... | 68 |
| 8.1. Grupet Punuese dhe Planet e Veprimit të Strategjive Nacionale | 70 |
| 8.2. Objektivat e përcaktuara në Planin Vjetor të Punës së Ministrisë së Financave dhe Programin e Qeverisë | 70 |
| 8.3. Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA)..... | 71 |
| 8.4. Sfidat për të ardhmen në përmbushjen e planit të performances dhe strategjive tjera kombëtare..... | 72 |

LISTA E SHKURTESAVE

| | |
|-----------|--|
| NJIF | Njësia për Inteligjencë Financiare |
| PPP | Parandalimi i Pastrimit të Parave |
| PFT | Parandalimi i Financimit të Terrorizmit |
| LPP/LFT | Luftimi i Pastrimit të Parave/Luftimi i Financimit të Terrorizmit |
| AIF | Raporti i informacioneve shtesë |
| AK | Agjencia Kadastrale e Kosovës |
| AKI | Agjencia e Kosovës për Inteligjencë |
| AKK | Agjencia kundër Korrupsionit |
| AAPSK | Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar |
| ARBK | Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë |
| ARC | Agjencia për Regjistrim Civil |
| ATK | Administrata Tatimore e Kosovës |
| BE | Bashkimi Evropian |
| BPCJF | Bizneset dhe Profesionet e Caktuara Jofinanciare |
| BQK | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës |
| DBJN | Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar |
| DHKEK | Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (brenda PK) |
| DK | Dogana e Kosovës |
| DKT | Drejtoria kundër Terrorizmit – (brenda PK) |
| DRNOJQ | Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të |
| EGMONT | Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë |
| EULEX | Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë |
| FATF/TFVF | Task Forca e Veprimit Financiar |
| FMN | Fondi Monetar Ndërkombëtar |
| FT | Financimi i Terrorizmit |
| goAML | Sistemi elektronik i menaxhimit të dhënave |
| IFJB | Institucionet Financiare Jobankare |
| IGJK | Instituti Gjyqësor i Kosovës |
| ILECU | Njësia për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit |
| IMF | Institucion Mikrofinanciar |
| IPA | Instrumenti i Asistencës para Anëtarësimit (i Komisionit Evropian) |
| KDK | Kujdesi i Duhur ndaj Klientit |
| KiE | Këshilli i Evropës |
| KKLKE | Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik |
| KP | Kodi Penal |
| KPP | Kodi i Procedurës Penale |
| MF | Ministria e Financave |
| MM | Marrëveshje e mirëkuptimit |
| MONEYVAL | Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave |
| NNJ | Ndihma e Ndërsjellë Juridike |
| OAK | Oda e Avokatëve të Kosovës |

| | |
|--------|--|
| OJQ | Organizatë joqeveritare |
| OKB | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| ONK | Oda e Noterëve të Kosovës |
| PECK | Projekti i BE&KiE “Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë” |
| PEP | Personat e Ekspozuar Politikisht. |
| PK | Policia e Kosovës |
| PP | Pastrimi i parave |
| PSO | Procedura Standarde të Operimit |
| PSRK | Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës |
| QIF | Qendra e Inteligjencës Financiare (paraardhësi i NJIF-it) |
| RKSOKB | Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara |
| RTD | Raporti i Transaksionit të Dyshimtë |
| RTG | Raporti i transaksionit në të gatshme (kesh) |
| SHKAÇK | Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar të Kosovës |
| TI | Teknologjia Informative |
| UNDP | Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara |
| UNMIK | Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë |
| UNODC | United Nations Office on Drugs and Crime/Zyra e Kombeve të Bashkuara kundër krimit dhe drogave |
| VKR | Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut |
| ZKK | Zyra Kadastrale Komunale |

1. HYRJA

Bazuar në nenin 10 të Ligjit Nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, NJIF-K publikon raportin vjetor 2016.

Kosova mbetet e përkushtuar në fuqizimin e mekanizmave ligjor e institucional për luftë sa më efektive të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Luftimi efektiv i këtyre dukurive mbetet njëra ndër sfidat e vendit tonë drejt rrugëtimit për anëtarësim në institucionet ndërkombëtare dhe përafrim me standardet ndërkombëtare. NJIF-K si institucioni qendror i pavarur kombëtar, ka vlerësuar si qenësore që të kemi bazën e duhur ligjore dhe të sigurohemi që sikurse sektori publik ashtu dhe sektori privat kanë mjetet dhe ndërmarrin masat e duhura në mënyrë që të parandalojnë dhe luftojnë pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Këto përpjekje rezultuan me miratimin e ndryshimeve ligjore të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftim të financimit të terrorizmit.

NJIF-K siguron në mënyrë periodike dhe koordinon vlerësimin kombëtar të rrezikut për sa i përket pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për të identifikuar dhe vlerësuar rrezikun dhe për t'i bërë rekomandime Qeverisë në përcaktimin e politikave, strategjive dhe masave për menaxhimin e rrezikut dhe për të zvogëluar rreziqet e identifikuara.

Ne si NJIF-K do të vazhdojmë përpjekjet tona për t'iu përshtatur gjithnjë e më shumë zhvillimeve të hovshme të teknologjisë me qëllim të identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Të dhënat për vitin 2016 tregojnë për një vit në progres të rezultateve, duke përmbushur dhe tejkaluar indikatorët kyç të performancës të përcaktuara në kuadër të Strategjisë Kombëtare 2014-2018. Ka pasur ngritje prej rreth 22% të numrit të raporteve të transaksioneve të dyshimta të raportuara në NJIF-K. Është shënuar ngritje prej rreth 19 % të numrit të raporteve të inteligjencës të shpërndara tek autoritetet tjera, duke tejkaluar objektivat e përcaktuara në planin e performancës NJIF-K.

Procesi i anëtarësimit në EgmontGroup dhe organizatat tjera ndërkombëtare mbetet ndër prioritetet me rëndësi për NJIF-K. Për këtë qëllim, janë bërë përpjekje maksimale nganjësiadhe autoritetet tjera në Kosovës që të plotësohen të gjitha kushtet për anëtarësim të kërkuara nga grupet punuese të Egmont. Është miratuar Ligji i ri për PPP/LFT dhe është shënuar progres në këtë drejtim.

NJIF-K po ashtu do të vazhdojë projektet të cilat janë duke u zhvilluar në përmirësimin dhe ngritjen e sistemit të TI-së dhe të zhvillimit të bazave të të dhënave, procedurave të brendshme dhe të jashtme të institucionit, ngritjen e vazhdueshme të bashkëpunimit me subjektet raportuese dhe vetëdijesimit të tyre rreth obligimeve ligjore mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, ngritjen e bashkëpunimit me institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare (agjencitë tjera homologe) si dhe vazhdimin e plotësimin të infrastrukturës ligjore (hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e dokumenteve strategjike dhe akteve tjera nënligjore) në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe evropiane sa i përket kësaj fushe.

2. ORGANIZIMI I NJIF KOSOVA

2.1. Historiku i NJIF-K

Zhvillimet më të rëndësishme vendore dhe ndërkombëtare në fushën e PPP/LFT

Qendra e Inteligjencës Financiare - FIC

Rregullorja 2004/2 dhe themelimi i FIC Kosovë

- 2004 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) ka nxjerrë Rregulloren 2004/2, me të cilën ka themeluar Qendrën për Inteligjencë Financiare.
- 2004 Rregullorja e UNMIK-ut 2004/2 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale ka hyrë në fuqi më 1 Mars 2004.
- 2004 Qendra për Inteligjencë Financiare është bërë funksionale në Shtator të vitit 2004 nën menaxhimin e stafit ndërkombëtar të UNMIK-ut.
- 2005 Rregullorja Nr. 2005/9 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale.
- 2006 Rregullorja Nr. 2006/9 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale.
- 2006 Rregullorja Nr. 2006/53 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale.

Bartje e kompetencave nga UNMIK tek EULEX

- 2008 Dorëzimi i kompetencave të QIF nga UNMIK-u tek misioni i EULEX-it.
- 2008 Përdorimi i softuerit goAML.

Njësia e Inteligjencës Financiare - FIU

Ligji 03/L-196 për PPP/PFT

- 2010 Ligji Nr. 03/L-196 për PPP/PFT.
- 2010 Krijimi i NJIF-K si pasardhëse e Qendrës për Inteligjencë Financiare të Kosovës.
- 2010 Themelimi i Bordit Menaxhues të Njesisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës.
- 2012 Transferimi i kompetencave nga misioni i EULEX tek autoritetet vendore.
- 2012 Hyrja në fuqi e Kodit Penal dhe Procedurës të Republikës së Kosovës
- 2012 Strategjia për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit

Ligji Nr. 04/L-178

- 2013 Ligji Nr. 04/L-178 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit.
- Aplikimi për anëtarësim në Egmont Grup
- 2013 Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
- 2014 Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018
- Pjesëmarrja për herë të parë në takimin Plenar të Egmont Grup, Lima Peru


- 2014 Vlerësimi mbi pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e Luftimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (LPP/LFT) – PECK I
- 2015 Pjesëmarrja në takimin e grupeve punuese të Egmont Grup, Berlin Gjermani.

Ligji 05/L-096 për PPP/LPF

- 2016 Miratimi dhe hyrja në fuqi e Ligjit 05/L-096
- 2016 Ndryshimi i statusit të stafit profesional tëNJIF-K

2.2. Detyrat

NJIF-K është themeluar me Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (Ligji PPP/LFT)¹. Është institucioni qendror i pavarur kombëtar në kuadër të Ministrisë së Financave, përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit. Statusi i Njesisë për Inteligjencë Financiare, mandati dhe kompetencat e saj si dhe obligimet e subjekteve raportuese dhe përgjegjësitë e tyre janë të definuar në Ligjin për PPP/LFT.



Kompetencat dhe funksionet kryesore tëNJIF-K janë siç vijon:

1. Kërkimi, marrja, dhe analizimin i aktiviteteve/transaksioneve të dyshimta (RTD), raporteve të parave në të gatshme (RTG) dhe informatave nga burimet tjera në lidhje me dyshim për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
2. Shpërndarjen e informatave në lidhje me dyshimin për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit tek autoritetet kompetente për hetime të mëtutjeshme;
3. Të miratojë akte nënligjore, të lëshojë urdhra dhe udhëzues mbi çështjet që kanë të bëjnë me sigurimin ose promovimin e pajtueshmërisë me ligjin për PPP/LFT
4. Mbikëqyrja dhe inspektimi i subjekteve raportuese për të siguruar pajtueshmërinë me obligimet e raportimit dhe ruajtjes së shënimeve;
5. Shkëmbimi i informatave dhe bashkëpunimi me FIU homologe në juridiksionet tjera dhe me autoritetet tjera të mbikëqyrjes dhe hetimeve;
6. Trajnime për subjektet raportuese dhe autoritetet tjera të hetuesisë dhe personelit të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë;
7. Të hartojë statistika dhe raporte dhe pas kësaj t'i bëj rekomandime Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Policisë, Doganave të Kosovës dhe/ose personave apo organeve të tjera, në lidhje me masat që duhet të merren dhe legjislacionin që duhet të miratohet për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e aktiviteteve terroriste; dhe
8. Aplikimi i sanksioneve administrative për mos – pajtueshmëri nga subjektet raportuese.
9. Të kryejë analiza strategjike

¹ Ligji Nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, 2016

10. Koordinon vlerësimin kombëtar të rrezikut për sa i përket pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit
11. Të bëjë ngrirjen e përkohshme e transaksioneve

2.3. Buxheti dhe Prokurimi

2.3.1. Buxheti

Ndryshimet e reja ligjore kanë përcaktuar përdorimin në mënyrë të pavarur të buxhetit të NJIF-K duke specifikuar në nenin 4 të Ligjit për PPP/LFT përkufizimet e reja "NJIF-K ka buxhetin e vet i cili sigurohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit. NJIF-K vendosë në mënyrë të pavarur për shfrytëzim të buxhetit, në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë".

Buxheti i NJIF-K për vitin 2016, ndryshimet dhe procesi i realizimit të tij sikur edhe në vitet e mëparshme, si rezultat i planit mirë të analizuar, dhe në përputhje me objektivat dhe prioritetet e përcaktuara të saj, ka përmbyllur me sukses buxhetin për vitin 2016. Bazuar në procesin e planifikuar të shpenzimit të buxhetit në të gjitha kategoritë ekonomike, gjatë tërë viti 2016 ka arritur shkallën e realizimit 93%.

Ndarja buxhetore fillestare sipas ligjit të Buxhetit për vitin 2016, ka qenë 310,696 Euro. Me rishikim të buxhetit dhe azhurnime të brendshme nga MF, buxheti i NJIF-K është ngritur në 331,496 Euro.

| Kategoritë Ekonomike | Buxheti 2016 | Buxheti | Buxheti i shpenzuar |
|----------------------|-------------------|----------------|---------------------|
| | ndarja fillestare | pas rishikimit | realizimi |
| | 1 | 2 | 3 |
| Paga dhe mëditje | 193,536 | 199,336 | 189,431 |
| Mallra dhe shërbime | 75,685 | 90,685 | 83,792 |
| Shpenzimet komunale | 11,475 | 11,475 | 9,320 |
| Shpenzime kapitale | 30,000 | 30,000 | 25,919 |
| Gjithsej | 310,696 | 331,496 | 308,462 |

Tabela nr.1 - Tabela e ndarjeve dhe realizimit të buxhetit 2016

2.3.2. Aktivitetet e Prokurimit

Gjatë vitit 2016 sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 janë zhvilluar gjithsej dhjetë (10) aktivitete të prokurimit.

- Katër (4) Aktivitete të Prokurimit janë Zhvilluar nga NJIF-K,
- Gjashtë (6) Aktivitete të Prokurimit janë Zhvilluar nga AQP



Nisur nga kjo, aktivitetet e prokurimit që janë zhvilluar nga NJIF-K dhe sipas procedurës janë të ndara si në vijim:

- Një (1) aktivitet i prokurimit me procedurë të hapur,
- Një (1) aktivitet i prokurimit me procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.
- Dy (2) aktivitete kanë qenë me procedurën e vlerës minimale.

Ndërsa sipas vlerës se planifikuar të prokurimit janë zhvilluar aktivitetet si në vijim:

- Një (1) është me vlerë të mesme,
- Një (1) është me vlerë të vogël dhe.
- Dy (2) janë me vlerë minimale.

Përderisa aktivitetet që janë zhvilluar nga AQP që përfshinë gjithsej gjashtë (6) aktivitetet të prokurimit dhe të cilat të gjashtë (6) aktivitetet janë zhvilluar me procedurë të hapur Kontratë Kornizë.

Ndërsa sipas vlerës se planifikuar të prokurimit

- Katër (4) janë me vlerë të mesme.
- Katër (4) janë me vlerë të vogël dhe.
- Katër (4) janë me vlerë minimale.

Ndryshimet e reja ligjore në sferën e prokurimit kanë krijuar ndryshime në lidhje me procedurat e prokurimit të cilat janë zhvilluar nga NJIF-K.

Për qëllime të ekonomizimit të aktiviteteve të prokurimit, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministritë përkatëse kryejnë procedurat e prokurimit të Agjencive që i përgjigjen atyre, të cilat kanë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës.

Përderisa për Agjencitë e Pavarura të cilat i përgjigjen Kuvendit të Republikës së Kosovës, që kanë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës, procedurat e prokurimit i kryen Agjencia Qendrore e Prokurimit.

Kjo ka shtyrë NJIF-K që për të qenë në harmoni me ligjin të filloj me zhvillimin e procedurave të prokurimit në Ministrinë e Financave.

2.4. Organizimi i NJIF-K

2.4.1. Mbikëqyrja e NJIF-K

Bordi Mbikëqyrës i Njësisë për Inteligjencë Financiare mbikëqyrë dhe siguron pavarësinë e NJIF-K. Bordi nuk ka fuqi ekzekutive ose zbatimi kundrejt NJIF-K.

Bordi përbëhet nga Ministri i Financave, i cili do të shërbejë në cilësinë e Kryetarit të Bordit. Anëtarë të tjerë të bordit do të jenë, exofficio, Ministri i Punëve të Brendshme, Kryeprokurori i Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës dhe Guvernatori i BQK-së.

Bordi mban takim sa herë që puna e NJIF-K ta kërkojë këtë, por jo më pak se dy (2) herë në vit.

Ndryshimet e reja ligjore kanë vendosur mekanizëm përgjegjës përkitazi me bashkëpunimin dhe koordinimi kombëtar, duke i dhënë kompetenca Bordit Mbikëqyrës të kryejë funksionin e mekanizmit përgjegjës koordinues për përcaktimin e orientimit të politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të bazuar në rreziqet e identifikuar, si dhe për ngritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional në pajtim me qëllimet e ligjit për PPP/LFT. Për këtë qëllim, Bordi mund të krijojë grupe pune për të bashkërenduar aktivitetet në fushën e politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe përcaktimin e prioritetëve afatgjatë dhe afatshkurtra.

Nisur nga kjo, Bordi mund të ftojë edhe akterë tjerë nga sektori publik dhe privat.

2.4.2. Burimet njerëzore dhe Struktura organizative e NJIF-K

Plani i Përformances dhe Resurseve të Njesisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës 2015-2017 ka përcaktuar menaxhimin e burimeve njerëzore dhe objektivat e NJIF-K.

Zhvillimet e reja ligjore në fushën e PPP/LFT kanë bërë që të ndryshohet edhe statusi i stafit profesional të NJIF-K. Në nenin 4 të Ligjit 05/L-096 është specifikuar që *"Stafi profesional i NJIF-K nuk janë nëpunës civil. Megjithatë legjislacioni që rregullon çështjet e shërbimit civil zbatohet ndaj stafit të NJIF-K, përveç rasteve kur rregullohet ndryshe me këtë ligj dhe aktet tjera nënligjore të cilat do të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore të shërbimit civil"*. Tani me këtë ligj statusi i stafi profesional të NJIF-K është përcaktuar, por ende duhet përkrahje sa i përket mbrojtjes së tyre gjatë ushtrimit të detyrave dhe obligimeve që dalin nga ky ligj.

Në vitin 2016 është hartuar Draft - Rregullore për Organizimin e Brendshëm të NJIF-K e cila është përcjellur tek Bordi i NJIF-K për miratim. Kjo rregullore përveç qëllimit dhe fushëveprimit të saj, përmban edhe kapitujt që përcaktojnë organizimin e brendshëm të Njesisë për Inteligjencë Financiare duke qartësuar strukturën organizative të Njesisë për Inteligjencë Financiare, funksionet e zyrës së drejtorit, departamenteve dhe divizioneve. Përveç tjerash, rregullorja përmban edhe listën e pozitave në Njesisë për Inteligjencë Financiare dhe përcaktimin e detyrave për stafin profesional dhe atë administrativ të NJIF-K.


Në vitin 2016, në NJIF-K kanë qenë të punësuar gjithsej 18 zyrtarë, prej të cilëve strukturën e institucionit e përbëjnë Drejtori i njesisë, tre (3) zyrtarë administrativ dhe katërmëdhjetë (14) zyrtarë profesional. Për më tepër, me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së shkëmbimit të informatave dhe bashkëpunimin operacional në NJIF-K janë të angazhuar dy (2) zyrtar ndërlidhës nga institucionet vendore të zbatimit të ligjit, një nga Dogana e Kosovës dhe një nga Policia e Kosovës.

Mbi 50% e burimeve e përbën stafi i angazhuar në departamentet e analizave operationale dhe mbikëqyrjes së pajtueshmërisë të cilat janë orientuar në drejtim të mbështetjes së këtyre sektorëve.



Gjithë personeli i NJIF-K kanë përgatitje universitare dhe janë të kualifikuar dhe trajnuar, ku i gjithë stafi në njësi posedon përgatitje universitare, të paktën kualifikimin bachelor, kryesisht të diplomuar në ekonomi, juridik, shkencë kompjuterike ose inxhinieri elektrike dhe kompjuterike. Gjinia femërore përfaqësohet me rreth 39 % të të punësuarve në NJIF-K.

Struktura Organizative e Njesisë së Inteligjencës Financiare në vitin 2016 është siç vijon:



3. ZHVILLIMET LIGJORE PËR PPP/LFT

3.1. Zhvillimi i kornizës ligjore

Në muajin shkurt të vitit 2015, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte miratuar Koncept Dokumentin për ngritjen e nivelit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe pas kësaj me vendim me nr. protokolli 32/2015 të datës 13/02/2015 Sekretari i Ministrisë së Financave kishte themeluar grupin punues për plotësim ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-178, apo projektligjit të ri për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Grupi punues është zgjeruar me vendimin nr. 32-1/2015 të datës 02/07/2015 me ç'rast përveç përfaqësuesve nga institucionet e ndryshme relevante janë përfshirë edhe përfaqësues nga shoqëria civile.

Grupi punues kishte zhvilluar takime të vazhdueshme punuese, ndërsa me përfundimin e draftit fillestar janë organizuar edhe tryeza dhe konsulta të ndryshme edhe me subjektet raportuese dhe akterët e tjerë.

Me datë 25 Maj 2016 Parlamenti i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe luftimit të Terrorizmit i cili ligj është shpallur me dekretin Nr. DL-015-2016, datë 13.06.2016 nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe është publikuar në Gazetë Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 18, të datës 15 qershor 2016 ne ç'rast edhe ka hyrë në fuqi.

Qëllimi kryesor i ndryshimit të Ligjit ka qenë ngritja e nivelit të parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe përafrimi i tij me standardet ndërkombëtare dhe evropiane sa i përket kësaj fushe, qëllim ky i cili është synuar të realizohet përmes ndryshimeve ligjore të dispozitave të caktuara.

Në kuadër të Ligjit të ri janë shtuar përkufizime të reja si p.sh zyrtar i pajtueshmërisë, transaksion i rastit, marrëdhënie korrespondente dhe janë sqaruar më detajisht përkufizimet për pronar përfitues, personi i ekspozuar politikisht, akt ose transaksion i dyshimtë dhe të tjera.

Bordit Menaxhues, tani Bordi Mbikëqyrës i NJIF-K i është dhënë kompetenca që të kryen funksionin e mekanizmit përgjegjës koordinues për përcaktimin e orientimit të politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të bazuar në rreziqet e identifikuar, si dhe për ngritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional. Po ashtu janë inkorporuar edhe dispozita tjera të reja të cilat përcaktojnë më detajisht detyrat dhe kompetencat e këtij bordi.

Në kuadër të dispozitave ligjore të ligjit 05/L-096 janë përcaktuar më në detaje veprimet dhe masat që duhet të ndërmerren nga subjektet raportuese para, gjatë, dhe pas ekzekutimit të transaksionit ose krijimit të marrëdhënies afariste. Për qëllime të ndërmarrjes së këtyre masave, subjektet raportuese duhet të nxjerrin rregullore dhe procedura të brendshme të shkruara, vendosin kontrole për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe i zbatojnë ato.

Në kuadër të ndryshimeve të reja të këtij ligji, përveç obligimit që NJIF-K të siguron dhe koordinon në mënyrë periodike vlerësimin kombëtar të rrezikut për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit si dhe jep rekomandime Qeverisë në përcaktimin e politikave, strategjive dhe masave për menaxhimin e rrezikut dhe zvogëlimin e rreziqeve të identifikuara, ky nen tani përcakton gjithashtu obligime sa i përket vlerësimit të rrezikut që duhet të ndërmerren nga subjektet raportuese. Tani sipas dispozitave të reja të inkorporuar në kuadër të nenit 18 të gjitha subjektet raportuese duhet të përcaktojnë në mënyrë periodike rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ndaj të cilit janë të ekspozuara gjatë ofrimit të shërbimeve dhe produkteve të tyre, vendndodhjes gjeografike dhe mekanizmave e kanaleve të shpërndarjes.

Është ngritur niveli i cili ka të bëjë me kujdesin e duhur ndaj klientit që përcakton dispozita të reja që ndërlidhen me identifikim të klientit për bizneset e sigurimeve të jetës dhe sigurimet tjera të ndërlidhura me investime.

Në lidhje me mbajtjen e shënimeve është specifikuar kohëzgjatja e ruajtjes së kopjeve të dokumenteve që dëshmojnë identitetin e klientit, pronarin përfitues, llogaritë e dosjeve dhe korrespondencën biznesore, ruajtjen e informacioneve që mundësojnë rindërtimin e transaksioneve, ruajtjen e të dhënave për transaksionet që i referohen një serie transaksionesh të ndërlidhura dhe të kohëpaskohshme dhe informacionet për transaksionin që lidhet me një raport të dorëzuar në NJIF-K për sa i përket një akti apo transaksioni të dyshimtë. Gjithashtu në rastet e transfereve elektronike, nga bankat dhe institucionet financiare që kryejnë aktivitete të tilla kërkohet që të mbajnë një regjistër të të gjitha informatave përkatëse që shoqërojnë një transfer për sa i përket paguesit dhe marrin masa të nevojshme për të mbrojtur të dhënat nga dëmtimi dhe për të parandaluar qasjen e paautorizuar.

Sipas ligjit të ri janë specifikuar edhe disa detaje të rregullimit të funksionit të pajtueshmërisë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe është përcaktuar se rregullimi i hollësishëm i kritereve për “i përshtatshëm” dhe “i duhur” për zyrtar të pajtueshmërisë do të përcaktohet me akt nënligjorë.

Karakteristikë tjetër e këtij ligji, që nuk ka qenë në ligjet e mëparshme, është mundësia e aplikimit të kujdesit të duhur të thjeshtësuar nga subjektet raportuese në situatat në të cilat identifikohen fusha me rrezik më të ulët ndaj pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit dhe rrethanat nën të cilat mund të aplikohet kjo dispozitë.

Bankat dhe institucionet financiare tani janë të obliguara të sigurojnë se personat fizik apo juridik që veprojnë si degë, filialë apo agjentë në emër të tyre janë të përfshirë në programet për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe monitorohen për sa i përket pajtueshmërisë me dispozitat e ligji, si dhe lejohen të zbatojnë programe në kuadër të grupit që mbulojnë degët e tyre të huaja dhe filialet shumicë në pronësi, kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë politikat dhe procedurat për shkëmbimin e informatave brenda grupit.

Me Ligjin e ri është përcaktuar në mënyrë eksplicite edhe kompetenca e NJIF që të lëshojë urdhër me shkrim për ngrirjen e përkohshme të ekzekutimit të transaksioneve bazuar në

kërkesën me shkrim të arsyetuar të institucioneve homologe ndërkombëtare. Kjo kompetencë mundëson ngritjen e mëtutjeshme të bashkëpunimit ndërkombëtare dhe shkëmbimin e informatave që është element shumë i rëndësishëm në parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Sa i përket detyrimeve specifike të OJQ-ve ky ligj tanimë nuk përmban dispozita kufizuese për pranimin e donacioneve dhe kontributeve dhe marrjen e lejes nga NJIF-K, por tani kemi dispozita të cilat kanë të bëjnë me limite të përdorimit të parave në të gatshme me qëllim të rritjes së transparencës financiare dhe zvogëlimit të mundësisë së shfrytëzimit të tyre për pastrimin e parave dhe/ose si kanale të shpërndarjes së fondeve ose burimeve tek individët apo subjektet e lidhura me grupet ose organizatat terroriste.

Mbikëqyrja e pajtueshmërisë është elaboruar në kapitullin IV ku tani me këtë ligj përveç NJIF-K përcaktohen kompetencat mbikëqyrëse edhe për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës sa i përket sektorit financiar. Gjithashtu më këtë kapitull është paraparë edhe mundësia e delegimit të kësaj kompetence nga NJIF-K tek mbikëqyrësit e tjerë sektorial. Për dallim nga ligji i kaluar tani për NJIF-K dhe BQK me ligji e ri është përcaktuar edhe mundësia e mbikëqyrjes së pajtueshmërisë edhe nga distanca.

Mbajtjen e të Dhënave Statistikore dhe Informatave Kthyesë dhe obligimet tjera në lidhje me veprën penale të pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura dhe financimit të terrorizmit, tani janë përfshirë në një nen të ri, ku të gjitha autoritetet kompetente që kanë përgjegjësi për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe subjektet raportuese obligohen të mbajnë të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse përkatëse për fushën e tyre të përgjegjësisë dhe të vihen në dispozicion të NJIF-K brenda afateve kohore të përcaktuara, për t'i mundësuar që të rishikojë efektivitetin e sistemit kombëtar dhe për të bërë rekomandime.

Sfidë e ligjit të kaluar për NJIF-K ka qenë zbatimi i ndëshkimeve administrative për shkak të përcaktimit jo në harmoni me obligimet ligjore për subjektet raportuese. Në Kapitulli V të këtij ligji janë përcaktuar shkeljet të cilat janë ndarë në tri nivele, si shkelje shumë të rënda, të rënda dhe të lehta si dhe ndëshkime për tri llojet e shkeljeve si për personat fizik ashtu dhe persona juridik. Po ashtu në kapitullin VI është përcaktuar procedura e ndëshkimeve administrative dhe të gjitha detajet e tjera procedurale që kanë të bëjnë me ndëshkimet dhe ankesat.

Në kuadër të ligjit të ri në kapitullin IX është hartuar një nen i ri që ka të bëjë me mbrojtjen e të dhënave ku përcaktohen obligime për mbrojtjen e të dhënave nga NJIF-K dhe subjektet raportuese, ku është sanksionuar se grumbullimi, përpunimi dhe përdorimi dhe ruajtja e të dhënave personale nga subjektet raportuese kufizohet në atë që është e domosdoshme për qëllimin e veprimit në përputhshmëri me kërkesat e ligjit dhe në veçanti, ndalohet përpunimi i mëtejshëm i të dhënave personale për qëllime komerciale.

Ligji i ri obligon subjektet raportuese që të zbatojnë dispozitat e reja edhe për klientët ekzistues në bazë të materialitetit dhe rrezikut si pjesë e monitorimit të vazhdueshëm të llogarive dhe marrëdhënieve të biznesit.



3.2. Aktet nënligjore

3.2.1. Udhëzimet Administrative, Rregulloret dhe Procedurat Standarde të Veprimit

Me qëllim të zbatimit të dispozitave të reja ligjore aty ku ligji e përcakton apo aty ku paraqitet nevoja për sqarime më të detajuara për subjektet raportuese pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 05/L-096, NJIF-K ka filluar me hartimin e akteve nënligjore.

Fillimisht është hartuar plani i punës që përmban listën e akteve nënligjore të cilave i është dhënë prioritet i veçantë për tu hartuar, rishikuar apo plotësuar. Objektivi i NJIF-K është që të sigurohet implementim i plotë dhe korrekt i Ligjit për Parandalim të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.

NJIF-K gjatë vitit 2016 ka hartuar aktet nënligjore për të cilat ka konsultuar edhe subjektet raportuese dhe akterët e tjerë kompetent të cilat pritet të hyjnë në fuqi në tremujorin e parë të vitit 2017. Aktet nënligjore të hartuar janë si në vijim:


- Rregullorja për Funkcionin e Pajtushmërisë dhe Kriteret për “i Përshtatshëm” dhe “i Duhur” për Zyrtarin e Pajtushmërisë për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (rregullore e re),
- Udhëzimi Administrativ për Përrjashtimin e Transaksioneve të Caktuara nga Raportimi (plotësim ndryshim); dhe
- Udhëzuesi për vetë-vlerësim të subjektit raportues për procedurat për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit (udhëzues i ri).

Po ashtu janë hartuar edhe dy procedura standarde të operimit të cilat janë:

- Procedura Standarde e Operimit për Mbikëqyrjen e Pajtushmërisë (plotësim ndryshim); dhe
- Procedura Standarde e Operimit për Proceset e Punës bazuar në goAML (plotësim ndryshim);

Njëherit janë identifikuar edhe aktet tjera nënligjore të cilat pritet të hartohen dhe finalizohen përgjatë vitit 2017 siç janë:

- Udhëzim Administrative për parandalimin dhe zbulimin e financimit të terrorizmit (plotësim ndryshim),
- Udhëzim Administrativ për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave (plotësim ndryshim),
- Rregullore për përgatitjen dhe mbajtjen e statistikave, raporteve dhe rekomandimeve lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit (plotësim ndryshim),
- Udhëzim Administrativ për Personat e Ekspozuar Politikisht (plotësim ndryshim).



4. PERFORMANCA E NJIF KOSOVË

4.1. *Pranimi, analizimi dhe shpërndarja e inteligjencës financiare*

4.1.1. Të dhënat dhe raportet e proceduara

Njesisë për Inteligjence Financiare sipas Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit i është dhënë mandati të hartojë statistika dhe raporte dhe pas kësaj t'i bëjë rekomandime institucioneve kompetente dhe/ose personave apo organeve të tjera, në lidhje me masat që duhet të merren dhe legjislacionin që duhet të miratohet për të luftuar pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit.

Andaj, duke pasur parasysh legjislacionin në fuqi, standardet ndërkombëtare duke përfshirë rekomandimet e TaskForcespër Veprim Financiar (TFVF), konkretisht rekomandimin 33, si dhe duke pasur parasysh që ofrimi i statistikave, indikatorëve, raporteve dhe rekomandimeve mund të ndikoj pozitivisht në analizimin dhe marrjen e masave të duhura me qëllim të përmirësimit të aspekteve të ndryshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit si dhe mund të ndikoj në analizimin, qartësinë dhe lidhjen logjike në mes të aktiviteteve të ndryshme dhe ndërlidhjes së tyre me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.


NJIF-K, BQK, mbikëqyrësit e tjerë sektorial, autoritetet e tjera kompetente që kanë përgjegjësi për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, subjektet raportuese si dhe personat ose subjektet e tjera që kanë detyrime ose funksione sipas këtij ligji mbajnë të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse përkatëse për fushën e tyre të përgjegjësisë.

Tani me këtë ligj², për zyrtarë të pajtueshmërisë të cilët janë përgjegjës për ndërveprim dhe këmbim informatash me NJIF-K, ligji ofron mbrojtje në lidhje me zbulimin e të dhënave të tyre tek persona të paautorizuar, si dhe mbrojtjen e procedurave të tjera të cilat mund të ndikojnë në kryerjen pa pengesë të detyrave dhe qasjes së paautorizuar në të dhëna.

Forma e menaxhimit të raporteve të krijuara vitet e kaluara, ka krijuar një bazë të mirë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore. Të gjitha këto raporte mund të integrohen në sistem, qoftë përmes formës dhe mënyrës online të raportimit duke ngarkuar XML raportin në formatin XML, apo përmes formës manuale.

Përketë qëllim NJIF-K do të hartojë në vazhdimësi statistika dhe raporte si dhe do të bëjë rekomandime në ato fusha apo sektorë ku shihet se është e nevojshme qoftë në aspektin legjislativ apo në aspektet tjera teknike më qëllim të ngritjes së bashkëpunimit dhe vetëdijes lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit si në vijim:


²Nr. 05/L-096 për PPP/LFT



- Statistika të përgjithshme rreth raporteve të transaksioneve të dyshimta dhe raporteve të parave në të gatshme;
- Statistika lidhur me raportet e transaksioneve të dyshimta rreth pastrimit të parave të raportuara nga subjektet raportuese;
- Statistika lidhur me raportet e transaksioneve të dyshimta rreth financimit të terrorizmit të raportuara nga subjektet raportuese;
- Statistika të cilat ndërlidhen me indikatorët e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit;
- Statistika lidhur me numrin e rasteve të hapura nga NJIF-K;
- Statistika lidhur me rastet e analizuar dhe dërguara te institucionet e zbatimit të ligjit nga NJIF-K;
- Statistika lidhur me numrin e kërkesave për informata të pranuar nga institucionet e zbatimit të ligjit;
- Statistika lidhur me numrin e rasteve për të cilat ka pasur shkëmbim informatash me FIU-të tjerandërkombëtare;
- Statistika lidhur me numrin e personave të hetuar dhe dënuar lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
- Statistika lidhur me pasurin e konfiskuar apo sekuestruar lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
- Statistika lidhur me numrin e trajnimeve të pranuar apo dhëna nga NJIF-K;
- Statistika lidhur me numrin e inspektimeve të pajtueshmërisë;
- Statistika lidhur me ndëshkimet administrative; dhe
- Statistika tjera të cilat i përkasin dhe janë nën mandatin ligjor të NJIF-K.

NJIF-K do të mbajë të dhëna statistikore të cilat janë cekur më lartë dhe së paku një herë në vit do të bëjë publike të dhëna statistikore.

Gjatë këtij viti, në sistemin elektronik të NJIF-K janë proceduar gjithsej 11,113 raporte.



Grafiku Nr.1 – Numri i raporteve të proceduara përmes sistemit elektronik dhe online 2016

Numri i raporteve të gjithëmbarshme të pranuar në vitin 2016 është rritur për rreth 30% krahasuar me një vit më parë. Kjo rritje e raporteve është ndikuar kryesisht nga rritja e numrit të Raporteve të informatave shtesë (rreth 59%), pastaj raportimet gjatë këtij vitijane karakterizuara me një ngritje të numrit të transaksioneve të dyshimta (rreth 22% më tepër se një vit më parë). Ngritje e theksuar është shënuar edhe në dërgimin e njoftimeve rreth transaksioneve të pazakonshme (UTR).

| Viti | 2015 | 2016 | +/- |
|------------------|--|--------|--------|
| Lloji i Raportit | Numri i të dhënave dhe raporteve të procesuara | | |
| AIF | 3,975 | 6,325 | +59% |
| BCR | 6 | 2 | -67% |
| CTR | 2,339 | 2,396 | +2% |
| ER | 15 | 10 | -33% |
| FRZ | 6 | 85 | +1317% |
| INR | 26 | 17 | -35% |
| IRD | 110 | 113 | +3% |
| IRI | 17 | 16 | -6% |
| ORD | 1,616 | 1,628 | +1% |
| ORI | 17 | 13 | -24% |
| STR (PP) | 395 | 480 | +22% |
| TFR | 3 | 5 | +67% |
| UTR | 3 | 23 | +667% |
| Gjithsej: | 8,528 | 11,113 | +30% |

Tabela Nr.2 – Numri i raporteve të proceduara përmes sistemit elektronik dhe online 2015-2016

4.1.2. Raportimi i Transaksioneve të Dyshimta

Ligji 05/L-096 për parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit i obligon subjektet raportuese të raportojnë aktet ose transaksionet e dyshimta brenda një periudhe kohore të përcaktuar me ligjin në fuqi, varësisht nga sektori apo subjekti raportues, nga koha kur akti ose transaksioni është identifikuar si i dyshimtë.

Të dhënat tregojnë se trendi i raportimit të transaksioneve ose akteve të dyshimta ka vazhduar të rritet dukshëm gjatë vitit 2016. Gjatë këtij viti, NJIF-K ka pranuar gjithsej 485 raporte të aktiviteteve ose transaksioneve të dyshimta. Kjo korrespondon me një rritje prej

Raportimi tek NJIF-K Neni 26

Të gjitha subjektet raportuese raportojnë tek NJIF-K, sipas mënyrës dhe formës së specifikuar nga NJIF-K, të gjitha aktivitetet ose transaksionet e dyshimta brenda njëzetekatër (24) orëve nga koha kur aktiviteti ose transaksioni është identifikuar si i dyshimtë.

Akt ose Transaksion i Dyshimtë nënkupton një akt ose transaksion ose një akt ose transaksion i tentuar, që krijon dyshim të arsyeshëm se pasuria e përfshirë në aktin apo transaksionin, ose në aktin ose transaksionin e tentuar, është produkt i krimi apo ndërlidhet me financimin e terrorizmit.

rreth 22% krahasuar me një vit më parë.

Nisur nga kjo, këto të dhëna tregojnë se NJIF-K-ja ka përmbushur dhe tejkaluar (për më tepër se 50%) indikatorët kyç të performancës të përcaktuara në Shtojcën 1 të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018. Treguesit kyç të performancës për matjen dhe monitorimin e efikasitetit të kësaj Strategjie ndër të tjera kanë përcaktuar numrin minimal të raporteve të pranuar të transaksioneve të dyshimta (RTD). Këta tregues kanë paraparë që NJIF-K për vitin 2016 të pranojë 250 raporte të transaksioneve të dyshimta, përderisa rezultatet kanë treguar që në këtë vit janë pranuar 485 raporte të tilla. Kjo tregon për një ngritje të theksuar të raportimit të RTD-ve dhe tejkalim të numrit të paraparë në Planin e Veprimit.


Nisur nga kjo perspektivë, përveç që ka rezultuar me rritje të numrit dhe cilësisë së RAD, është cilësuar se ka pasur zhvillime pozitive të arritura në lidhje me masat parandaluese të ndërmarra nga subjektet raportuese, është bërë një zgjerim i vogël i kategorisë së subjekteve që kanë raportuar RAD, si dhe ka vazhduar raportimi i tillë në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit.

Edhe këtë vit numri më i madh i raporteve të dyshimta me rreth 93% kanë ardhur nën dyshimet për pastrim të parave, përderisa raportimet për financim të terrorizmit përfshijnë rreth 7% të dyshimeve të ngritura gjatë vitit.

Numri më i madh i RTD-ve të pranuar në vitin 2016 apo rreth 96% e tyre, janë proceduar për t'u analizuar nga NJIF-K në vitin në shqyrtim, ndërsa pjesa tjetër (rreth 4%) mbetet të analizohet në vitin pasues.

| Treguesi Kyç i Përfomances | Muaji | 01 | 02 | 03 | 04 | 05 | 06 | 07 | 08 | 09 | 10 | 11 | 12 | Gjithsej RTD 2016 | % |
|---|-------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-------------------|----------------|
| Numri i raporteve të marra mbi transaksionet e dyshimta PP (RTD) | | 22 | 22 | 66 | 37 | 20 | 33 | 32 | 39 | 42 | 42 | 54 | 44 | 453 | 93% |
| Numri i raporteve të marra mbi dyshimin e financimit të terrorizmit | | 1 | 1 | 5 | 3 | 0 | 2 | 5 | 0 | 4 | 1 | 8 | 2 | 32 | 7% |
| Gjithsej | | 23 | 23 | 71 | 40 | 20 | 35 | 37 | 39 | 46 | 42 | 62 | 46 | 485 | 100.00% |

Tabela Nr.3 -RTD në muaj të pranuar për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit 2016




4.1.2.1. Raportimi i Transaksioneve të Dyshimta 2011-2016

Krahasimi i të dhënave statistikore tregon për një trend në ngritje të vazhdueshme të raportimeve për transaksione të dyshimta. Krahasuar me vitin 2011, numri i RTD-ve është ngritur për rreth 259%.

Sektori financiar duke veçuar Bankat dhe Agjensionet e Transferit të Parave mbulojnë mbi 90% të numrit të gjithëmbarshëm të raportimit të transaksioneve të dyshimta. Këto institucione vazhdojnë të mbajnë primatin e raportimit të RTD-ve edhe në vitin 2016. Bankat Komercale vazhdojnë të përbëjnë numrin më të madh të raportimit të transaksioneve të dyshimta (90%). Nga sektori tjetër financiar, Agjensionet e transferit të parave përbëjnë rreth 7% të raportimit, përdërisa ka ngritje të numrit të raportimit edhe nga Institucionet Mikrofinanciare, rezultat i së cilës mund të jenë trajnimet e mbajtura me këto institucione viteve të kaluara, përfshirë edhe trajnimet në vitin 2016.

Pavarësisht masave vetëdijësuese të ndërmarra gjatë këtyre viteve, trajnimeve dhe punëtorive të organizuara për subjektet raportuese, Kompanitë e Sigurimit dhe Këmbimoret të listuara tek institucionet financiare dhe të obliguara të raportojnë transaksione të dyshimta, nuk kanë raportuar transaksione të tilla.

Grafiku dhe tabela në vijim tregojnë për trendin e raportimeve të bëra në vitet 2011-2016:



Grafiku Nr.3-Numri i RTD-ve të raportuara 2011-2016

| Vitet | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|------------------|------|------|------|------|------|------|
| RTD-të e pranuar | 135 | 202 | 174 | 295 | 398 | 485 |

Tabela nr.4 - Numri i RTD-ve të raportuara 2011-2016

Bizneset dhe profesionet e caktuara jo financiare (BPCJF-të)³vazhdojnë të kenë numra shumë modest në raportimin e RTD-ve. Me përjashtim të 2 raporteve nga Noterët të raportuara në NJIF-K, profesionet tjera nuk kanë raportuar ndonjë RTD gjatë viteve të fundit.

Zhvillimet për vetëdijesimin e profesionistëve në fjalë për përmbushjen e obligimeve të tyre ligjore do të fuqizohen edhe më tepër duke ndërmarrë veprime drejt organizimit dhe mbajtjes së trajnimeve dhe duke ngritur aktivitetet e mbikëqyrjes së pajtueshmërisë bazuar në rrezik me qëllim të pajtueshmërisë e tyre me legjislacionin në fuqi.

³ Avokatët, Auditorët dhe Kontabilistët, Noterët, Lojrat e Fatit, Metalet e çmueshme



| Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve 2011-2016 | | | | | | | |
|--|------------|------------|------------|------------|------------|------------|--------------------|
| SubjektetRaportuese | 2011 | 20122 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | Gjithsej 2011-2016 |
| Bankat | 129 | 196 | 165 | 234 | 350 | 438 | 1512 |
| InstitucionetMikrofinaciare | 0 | - | - | - | 2 | 6 | 8 |
| Kompanitë e Sigurimeve | 0 | - | - | - | - | - | 0 |
| Këmbimore (Këmbimi i valutave) | 0 | - | - | 1 | - | - | 1 |
| Agjensionetpër Transfer Parash | 3 | 6 | 6 | 58 | 39 | 34 | 146 |
| Kazinot | 0 | - | - | - | - | - | 0 |
| Agjentët e patundshmërive | 0 | - | - | - | - | - | 0 |
| Tregtarët me metale/gurë të çmuar | 0 | - | - | - | - | - | 0 |
| Avokatët | 0 | - | - | - | - | - | 0 |
| Noterët | 0 | - | 1 | - | - | 2 | 3 |
| Kontabilistët e çertifikuar dhe këshilltarët tatimor | 0 | - | - | - | - | - | 0 |
| Auditorët e liçencuar | 0 | - | - | - | - | - | 0 |
| Ofruesit e shërbimevetëtrustitdhekompanive | 0 | - | - | - | - | - | 0 |
| Profesionistët e tjerë | 0 | - | - | - | - | - | 0 |
| Organizatata Jo-Qeveritare | 0 | - | - | - | - | - | 0 |
| Shitësit e metaleve të çmuara dhe tregtarët me gurë të çmuar | 0 | - | - | - | - | - | 0 |
| Dogana e Kosoves | 3 | - | 1 | 1 | 4 | 1 | 10 |
| Mbikqyresitsektorial | 0 | - | - | - | 2 | 2 | 4 |
| Tjera | 0 | - | 1 | 1 | 1 | 2 | 5 |
| Gjithsej RTD-të e raportuar 2011-2016 | 135 | 202 | 174 | 295 | 398 | 485 | 1689 |

Tabela nr.5- Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve 2011-2016



Informacionet statistikore mbi raportet e dyshimta (RTD) te pranuar nga NJIF

| Subjekti raportues | 2013 | | 2014 | | 2015 | | 2016 | |
|--|---|----------|---|-----------|---|-----------|---|-----------|
| | Raporet në lidhje me transaksionet e dyshimta | | Raporet në lidhje me transaksionet e dyshimta | | Raporet në lidhje me transaksionet e dyshimta | | Raporet në lidhje me transaksionet e dyshimta | |
| | PP | FT | PP | FT | PP | FT | PP | FT |
| Bankat dhe Institucionet Financiare | | | | | | | | |
| Bankat Komerciale | 159 | 6 | 219 | 15 | 327 | 23 | 419 | 19 |
| Institucionet Mikrofinanciare | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 6 | 0 |
| Kompanitë e Sigurimeve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Këmbimoret (Këmbimi i valutave) | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Agjensioet për Transfer Parash | 6 | 0 | 57 | 1 | 36 | 3 | 19 | 15 |
| Gjithsej Bankat dhe Institucionet Financiare | 165 | 6 | 277 | 16 | 365 | 26 | 444 | 34 |
| BPPJF-të dhe Entitetet tjera raportuese | | | | | | | | |
| Kazinot | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Agjentët e patundshmërive | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Tregtarët me metale/gurë të çmuar | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Avokatët | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Noterët | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 |
| Kontabilistët e certifikuar dhe këshilltarët tatimor | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Auditorët e licencuar | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Ofruesit e shërbimeve të trustit dhe kompanive | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Profesionistët e tjerë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Organizatat Jo-Qeveritare | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shitësit e metaleve të çmuara dhe tregtarët me gurë të çmuar | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kompanitë e ndërtimit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Gjithsej BPPJF-të dhe Entitetet tjera Raportuese | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 |
| Raportet dhe informacionet tjera | | | | | | | | |
| Dogana e Kosoves | 0 | 1 | 1 | 0 | 4 | 0 | 1 | |
| Mbikqyresit sektorial | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 1 | 1 |
| Tjera | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| Gjithsej raportet dhe informacionet tjera | 1 | 1 | 2 | 0 | 7 | 0 | 3 | 2 |
| Gjithsejt RTD e pranuar për PP/FT | 167 | 7 | 279 | 16 | 372 | 26 | 449 | 36 |
| Gjithsej RTD e raportuara | 174 | | 295 | | 398 | | 485 | |

Tabela nr.6 - Informacionet për raportet e dyshimta (RTD) për PP dhe FT te raportuara në NJIF-K 2013-2016



4.1.3. Transaksionet e dyshimta për Financim të Terrorizmit


Dispozitat ligjore për raportimin e transaksioneve të dyshimta për financim të terrorizmit janë përcaktuar qartë në ligjin për PPP/LFT, për të cilat subjektet raportuese raportojnë një akt ose transaksion ose një akt ose transaksion të tentuar, që krijon dyshim të arsyeshëm se pasuria e përfshirë në aktin apo transaksionin, ose në aktin ose transaksionin e tentuar, është i ndërlidhur me financimin e terrorizmit.

Ngjarjet globale dhe zhvillimet e viteve të fundit në sferën ndërkombëtare të ndërlidhura me ngritjen e akteve terroriste dhe terrorizmit kanë ndikuar dhe janë reflektuar edhe në vendin tonë, gjë që ka bërë të ngritet vigjilenca e institucioneve publike dhe private në drejtim të parandalimit të këtyre dukurive negative. Kjo njëherit ka ndikuar në ngritjen e raportimit të transaksioneve ose aktiviteteve të dyshimta për financim të terrorizmit.

Në Kosovë janë miratuar një sërë dokumentesh strategjike dhe janë bërë ndryshimet e nevojshme ligjore me qëllim që mekanizmat luftues dhe parandalues në vend të jenë sa më afër përputhshmërisë me standardet dhe konventat tjera ndërkombëtare. Nisur nga kjo, NJIF-K ka qenë e orientuar ta shtrijë aktivitetin e saj në drejtim të ngritjes së efektshmërisë së regjimit raportues dhe zhvillimit të mëtejshëm të sistemit parandalues nga të detyruarit e ligjit.

Kur subjektet raportuese vërejnë se rreziku i pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit është ngritur, ato marrin masa të arsyeshme për të mbajtur të azhurnuara informacionet e mbledhura, masa për të zvogëluar këto rreziqe dhe zbatojnë masat e nevojshme të kujdesit të duhur të shtuara për të monitoruar profilin e biznesit dhe të rrezikut, duke përfshirë burimin e fondeve, dhe të sigurojnë që të dhënat dhe informacionet e tjera janë mbajtur të azhurnuara. Kjo përveç tjerash përfshinë kujdesin e duhur të shtuar të cilën subjektet raportuese duhet ta ndërmarrin si rezultat i pajtueshmërisë me masat parandaluese.

Midis viteve 2013 dhe 2016, numri i RTD-ve të dorëzuara për financim të terrorizmit është rritur dukshëm nga viti në vit, e cila tregon se ka ngritje të vigjilencës së subjekteve raportuese dhe një nivel më të lartë të vetëdijes për PPP/P FT në vendin tonë.



Grafiku Nr.4 – RTD të raportuara për Financim të Terrorizmit 2013-2016

Të dhënat statistikore të mirëmbajtura nga NJIF-K, tregojnë që gjatë vitit 2016, gjithsej 36 raporte të aktivitetit të dyshimtë për financim të terrorizmit janë pranuar në NJIF-K, duke pasuar një ngritje prej rreth 38% krahasuar me një vit më parë (2015: 26).

Kjo ngritje e numrit të RTD-ve për financim të terrorizmit është ndikuar kryesisht nga raportimet e bëra gjatë vitit 2016 nga Agjensionet e Transferit të Parave, gjë që është e kuptueshme marrë parasysh përdorimin e këtij sistemi për bartjen e fondeve për qëllime të dyshuara për financim të terrorizmit. Vërehet raportim i RTD-ve për FT edhe nga mbikëqyrësit sektorial dhe institucionet publike.

| Informacionet statistikore mbi raportet e dyshimta (RTD) të raportuara për Financim të Terrorizmit 2013-2016 sipas sektorëve | | | | |
|--|------|------|------|------|
| Subjektiraportues | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
| BankatKomercale | 6 | 15 | 23 | 19 |
| InstitucionetMicrofinaciare | - | - | - | - |
| Agjensionetpër Transfer Parash | - | 1 | 3 | 15 |
| Këmbimoret (Këmbimi i valutave) | - | - | - | - |
| BPPJF-të | - | - | - | - |
| Mbikqyresitsektorial | - | - | - | 1 |
| Dogana e Kosoves | 1 | - | - | - |
| Tjera | - | - | - | 1 |
| Gjithsej RTD-tëpërFinancimtëTerrorizmit | 7 | 16 | 26 | 36 |

Tabela nr.7 - Informacionet për raportet e dyshimta (RTD) për FT të pranuar nga NJIF-K 2013-2016

4.1.4. Raportimi i Transaksioneve në para të gatshme (RTG)

NJIF-K vazhdon të punoj ngushtë me subjektet raportuese për të zbatuar dhe përforcuar masat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në mënyrë që subjektet raportuese të mos përdoren për pastrimin e të ardhurave nga aktivitetet kriminale. Mes viteve 2012 dhe 2016, trendi i numrit të transaksioneve në para të gatshme të raportuara është rritur mbi 60%. Të dhënat e mbledhura nga këto RTG kanë shërbyer për të asistuar gjatë analizave të inteligjencës së NJIF-K.


Numri i transaksioneve të pranuar është ngritur nga 617,430 në vitin 2015 në 778,286 në vitin 2016 apo shprehur në përqindje rreth 26 % më tepër se sa vitin paraprak.

Sipas nenit 26 të Ligjit 05/L-096 për PPP/LFT (Raportimi tek NJIF-K):

të gjitha subjektet raportuese raportojnë tek NJIF-K, sipas mënyrës dhe formës së specifikuar nga NJIF-K, të gjitha transaksionet individuale në para të gatshme në vlerë dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë apo vlerës ekuivalente në valutë të huaj. Transaksionet e shumëfishta trajtohen si një transaksion individual nëse subjekti raportues është në dijeni se transaksionet janë nga apo në emër të një personi ose subjekti dhe kapin vlerën dhjetëmijë (10.000) euro apo në shumë brenda një (1) ditë të vetme

| Vitet | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|-------------------------|---------|---------|---------|---------|---------|
| RTG të pranauara | 480,479 | 606,778 | 553,651 | 617,430 | 779,217 |

Tabela nr.8 -RTG të raportuara për periudhën 2012-2016



Grafiku Nr.5 – Numri I RTG-ve të pranauara 2012-2016

Pavarësisht rritjes së numrit të raportimit të transaksioneve në para të gatshme, krahasuar me numrin e raporteve (2,436 RTG-ve) të dërguara gjatë vitit 2016, tregon se ishte i përafërt me vitin 2015 ku janë dërguar (2,367 RTG). Gjithashtu, shprehur në vlera monetare, raportimi i transaksioneve në para të gatshme ka mbetur i përafërt me vitin e kaluar, duke pësuar një ngritje të vogël prej rreth 5%.

| Raportet në lidhje me transaksionet mbi pragun e raportimit (RTG) të pranauara | | | | | | |
|--|--------------------------------|------------------------|--------------------------------|------------------------|--------------------------------|------------------------|
| Subjektiraportues | 2014 | | 2015 | | 2016 | |
| | Numri i Raporteve të pranauara | Numri i Transaksioneve | Numri i Raporteve të pranauara | Numri i Transaksioneve | Numri i Raporteve të pranauara | Numri i Transaksioneve |
| Bankat dhe Institucionet Financiare | | | | | | |
| Bankat | 1,700 | 548,139 | 2,028 | 614,162 | 2,087 | 774,463 |
| Institucionet Mikrofinanciare | 12 | 37 | 12 | 25 | 22 | 184 |
| Sektori I Sigurimeve | 3 | 11 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Këmbimoret | 297 | 2959 | 292 | 1875 | 297 | 2384 |
| Agjensionet për Transfer Parash | 25 | 500 | 23 | 104 | 18 | 99 |
| Gjithsej Bankat dhe Institucionet Financiare | 2,037 | 551,646 | 2,355 | 616,166 | 2,424 | 777,130 |
| Entitetet tjera raportuese | | | | | | |
| Dogana e Kosoves | 12 | 2005 | 12 | 1264 | 12 | 2087 |

| | | | | | | |
|-------------------------------------|-------|---------|-------|---------|-------|---------|
| Gjithsej entitetet tjera raportuese | 12 | 2005 | 12 | 1264 | 12 | 2087 |
| Gjithsej RTD e pranuar | 2,049 | 553,651 | 2,367 | 617,430 | 2,436 | 779,217 |

Tabela nr.9-Raportet në lidhje me transaksionet mbi pragun e raportimit (RTG) sipas sektorëve'14-'16

4.1.5. Raportimi i transaksioneve jo të zakonshme (Monitorimi special i transaksioneve të veçanta)

Subjektet raportuese i kushtojnë vëmendje të veçantë marrëdhënieve afariste dhe transaksioneve me personat, duke përfshirë personat juridik dhe marrëveshjet juridike dhe institucionet financiare nga ose në vende që nuk i aplikojnë ose i aplikojnë në mënyrë të pamjaftueshme standardet ndërkombëtare përkatëse për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.


Ligji 05/L-096 për PPP/LFT, përkatësisht neni 25 i këtij ligji ka përcaktuar si obligim ligjor për subjektet raportuese për monitorimin special të transaksioneve të veçanta, të cilat duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve të ndërlukuara dhe jashtëzakonisht të mëdha të cilat nuk kanë qëllime të qarta ekonomike ose ligjore.

Subjektet raportuese shqyrtojnë deri në masën e mundshme sfondin dhe qëllimin e transaksioneve të tilla dhe paraqesin me shkrim gjetjet e tyre dhe informacionin specifik në lidhje me transaksionet e tilla.

Viti 2016 ka shënuar ngritje jashtëzakonisht të madhe të numrit të raportimit të transaksioneve të tilla. Në këtë vit janë raportuar gjithsej 23 raporte për transaksione jo të zakonshme, vlera monetare e të cilave arrin shumën në total deri në rreth 16 mil euro.

| Vitet | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|-------------------------|------|-----------|-------------|-----------|--------------|
| UTR-të e pranuar | 0 | € 419,436 | € 1,001,320 | € 601,600 | € 16,176,800 |

Tabela nr.10- Raportimi i transaksioneve jo të zakonshme 2012-2016



Grafiku Nr.6 – Numri i UTR-ve të pranuar 2012-2016

4.1.6. Raportimi i Deklarimit Kufitar (Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës)

Sipas Ligjit 05/L-096 për PPP/LFT, Dogana e Kosovës zbaton nenin 33 të këtij ligji, e cila përveç tjerash e njofton NJIF-K për çdo deklarim ose mosdeklarim të mjeteve monetare që hyjnë ose dalin nga pikat e kalimit kufitar në valutë euro apo valutëtjetër të huaja në qoftë se arrihet pragu prej 10.000 euro apomë shumëapo vlerën ekuivalente.

Mosrespektimi i dispozitave për deklarim të mjeteve monetare nga personat fizik dhe juridik, kryen vepër të kundërvajtjes që dënohet me gjobë prej njëzet e pesë përqind (25 %) të shumës totale të instrumenteve monetare në posedim për të cilat ka detyrim për të deklaruar.

Në vitin 2016, NJIF-K është njoftuar në lidhje me shqiptimin e 2 gjobave për mosdeklarim të mjeteve monetare. Vlera e mjeteve monetare të mos-deklaruara ka qenë 28,000 €, përderisa është aplikuar gjoba për këtë mosdeklarim prej (25 %) apo 7,000 €.

Bazuar në harmonizimin e statistikave vjetore mes NJIF-K dhe Doganës, në vitin 2016, është raportuar se personat fizik dhe juridik kanë deklaruar gjithsej 1,156 Raporte të Deklarimit Kufitar (RDK), krahasuar me 1264 RDK të deklaruara një vit më parë. Vërehet ngritje e deklarimeve të mjeteve monetare nga Personat juridik (732 krahasuar me 606), përderisa ka rënie të numrit të deklarimeve nga Personat Fizik (424 në raport me 658).

Dogana e Kosovës si zbatuese e kësaj dispozite ligjore, vazhdon të raportojë rregullisht numrin e deklarimeve të tilla.

| Deklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare | | | |
|--|------------------|----------------|------------------------------|
| Numri i Raporteve të deklaruara | | | |
| Vitet | Personat Juridik | Personat Fizik | Numri I deklarimit te RTG-ve |
| 1 | 2 | 3 | 4 = (2+3) |
| 2016 | 732 | 424 | 1,156 |
| 2015 | 606 | 658 | 1,264 |
| 2014 | 667 | 583 | 1,250 |
| 2013 | 553 | 543 | 1,096 |
| Gjithsej | 1,826 | 1,784 | 3,610 |

Tabela nr.11 - Deklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare 2013-2016

Neni 33 Deklarimi i detyruar i qarkullimit të instrumenteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës

1. Secili person i cili hyn ose del nga Kosova dhe i cili bartë instrumente monetare në vlerën prej dhjetëmijë (10.000) euro apo më shumë, apo vlerën ekuivalente në valutë të huaj, paraqet me shkrim shumën e instrumenteve monetare dhe burimin e tyre të verifikueshëm në një formë e cila duhet të përcaktohet nga Dogana e Kosovës, para zyrtarit doganor.
2. Secili person i cili nga Kosova dërgon në një vend jashtë Kosovës ose i cili i pranon në Kosovë nga një vend tjetër jashtë Kosovës, përmes postës, ngarkesave kargo apo kuririt komercial, instrumente monetare në vlerë dhjetëmijë (10.000) euro apo më shumë apo vlerën ekuivalente në valutë të huaj, deklaron me shkrim shumën e instrumenteve monetare dhe burimin e tyre të verifikueshëm në një formë e cila përcaktohet nga Dogana e Kosovës.

Dogana e Kosovës merr të gjitha masat e duhura për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe raportojnë tek NJIF-K për çdo akt dhe transaksion të dyshimtë lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit që zbulon gjatë kryerjes së detyrave të saj. Dogana e Kosovës mban lidhje me NJIF-K, prokurorët, policinë dhe organet tjera përkatëse për qëllimin e kryerjes së këtyre detyrave. Në vitin 2016, NJIF-K ka pranuar nga Dogana e Kosovës një raport të transaksioneve të dyshimta aty ku ka pasur bazë për dyshim të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

4.1.7. Ngrirja e transaksioneve bankare

Ndryshimet e reja ligjore të ndodhur në vitin 2016, kanë përcaktuar dhe zgjeruar kompetencat ekzekutive të NJIF-K për ngrirjen e përkohshme të transaksioneve nëse vlerëson se ka bazë të arsyeshme për të dyshuar për pastrim parash ose financim të terrorizmit në lidhje me transaksionin ose personin që kryen transaksionin, për të cilin informon prokurorinë dhe organet tjera kompetente në mënyrë që të marrin masa brenda kompetencave të tyre.

Ngrirja e përkohshme mund të zgjasë për një periudhë maksimale prej dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i dhënies së urdhrimit për ngrirjen e përkohshme të transaksionit, me mundësi të zgjatjes edhe për njëzet e katër (24) orë shtesë. Gjatë kohës së ngrirjes së përkohshme të transaksionit, subjektet raportuese i nënshtrohen urdhrimit të NJIF-K.

Në këtë vit raportues NJIF-K ka lëshuar 85 udhëzime për pezullim të përkohshëm të transaksionit ose ngrirje të llogarisë, shprehur në vlerë totale në shumë prej rreth 1.1 milion euro, përderisa në vitin 2015 janë lëshuar 6 urdhëresa të tilla në vlerë totale prej 29,739.93 Euro, kurse në vitin 2014 numri i urdhëresave të lëshuara nga NJIF-K ka qenë 20 dhe janë ngrirë fonde në vlerë prej rreth 774,115 Euro.

| Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit | 2014 | 2015 | 2016 |
|--|-----------|----------|-------------|
| Numri i udhëzimeve të lëshuara për pezullim të transaksionit | 20 | 6 | 85 |
| Shuma (EUR) | 774,115 € | 29,740 € | 1,036,146 € |

Tabela nr.12 -Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit 2014-2016

Me Ligjin e ri është përcaktuar në mënyrë eksplicite edhe kompetenca e NJIF që të lëshojë urdhër me shkrim për ngrirjen e përkohshme të ekzekutimit të transaksioneve bazuar në kërkesën me shkrim të arsyetuar të institucioneve homologe ndërkombëtare. Kjo kompetencë mundëson ngritjen e mëtutjeshme të bashkëpunimit ndërkombëtare dhe shkëmbimin e informatave që është element shumë i rëndësishëm në parandalimin dhe

Neni 28 Ngrirja e përkohshme e transaksionit në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtarë

NJIF-K mund të lëshojë urdhër me shkrim për ngrirjen e përkohshme të ekzekutimit të transaksioneve, bazuar në kërkesën me shkrim të arsyetuar të çdo homologu të huaj që kryen funksione të ngjashme me NJIF-K, nën kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe si subjekt i reciprocitetit.

luftimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Për më tepër, NJIF-K mund të kërkojë nga çdo homolog i huaj që kryen funksione të ngjashme me NJIF-K të urdhërojë ngrirjen e përkohshëm të transaksioneve nëse ka bazë të arsyeshme për të dyshuar për pastrim të parave ose financim të terrorizmit në lidhje me transaksionin ose personin.

4.1.8. Kërkesat e OJQ-ve për përjashtim nga ndalesat ligjore

Sa i përket detyrimeve specifike të OJQ-ve ligji i ri për PPP/LFT tanimë nuk përmban dispozita kufizuese për pranimin e donacioneve dhe kontributeve dhe marrjen e lejes nga NJIF-K, por tani kemi dispozita të cilat kanë të bëjnë me limite të përdorimit të parave në të gatshme të njohur si para kesh me qëllim të rritjes së transparencës financiare dhe zvogëlimit të mundësisë së shfrytëzimit të tyre për pastrimin e parave dhe/ose si kanale të shpërndarjes së fondeve ose burimeve tek individët apo subjektet e lidhura me grupet ose organizatat terroriste.

OJQ-të janë të obliguara t'i raportojnë NJIF-K, të gjitha aktet apo transaksionet e dyshimta. Në përputhje me detyrimet e tyre si subjekte raportuese sipas ligjit për PPP/LFT, anëtarët e Bordit dhe stafi me përgjegjësi në menaxhimin e OJQ-së sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, marrin masa të duhura për të siguruar që OJQ-të nuk do të shfrytëzohen për pastrimin e parave ose si kanale të shpërndarjes së fondeve ose burimeve tek individët apo subjektet e lidhura me grupet ose organizatat terroriste.

OJQ-të ruajnë të dhënat financiare/librat e kontabilitetit të cilat dëshmojnë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet. Këto të dhëna identifikojnë të ardhurat sipas burimit, sasisë dhe mënyrës së pagesës, si dhe do të identifikojnë shumat e paguara sipas marrësit, destinimit të shfrytëzimit të fondeve dhe mënyrës së pagesës. Dokumentet për të dhënat financiare ruhen pesë (5) vite dhe janë në dispozicion sipas kërkesës së NJIF-K-së dhe organit kompetent sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.

4.1.9. Analizimi i raporteve të inteligjencës


Të dhënat tregojnë që gjatë vitit 2016 ka pasur ngritje prej 29% të numrit të rasteve të hapura për analizim nga ana e NJIF-K. Krahasuar me një vit më para në të cilin janë hapur gjithsej 247 raste, viti 2016 ka pasuar me hapjen e gjithsej 318 raste për analiza financiare nën dyshimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo veprave tjera të ndërlidhura. Rreth 57 % e rasteve të hapura në këtë vit kanë rrjedhur nga raportet e transaksioneve të dyshimta, përderisa kërkesat për informata përbëjnë rreth 36% të numrit total të rasteve të hapura gjatë këtij viti raportues. Ka shënuar ngritje gjithashtu edhe ngritja e numrit të rasteve nga projektet e përbashkëta të analizave/hetimeve me Institucionet tjera të zbatimit të ligjit.

Rritja e numrit të rasteve të hapura nga transaksionet e dyshimta të raportuara në NJIF-K (44% më tepër se vitin 2015) kanë ardhur edhe si rezultat i ngritjes së numrit të RTD-ve, përderisa dallimi në mes të numrit të RTD-ve dhe numrit të rasteve të hapura i referohet edhe rasteve në

të cilat më shumë se një RTD ishte raportuar për persona apo subjekte të ngjashme në periudha të ndryshme kohore, si dhe një pjesë e RTD-ve kanë mbet për t'u analizua në periudhat e ardhshme kohore.

| Rastet e Hapura | 2015 | 2016 | +/- |
|--|-------------|-------------|---------------|
| Rastet e hapura bazuar në RTD | 125 | 180 | +44.00 |
| Rastet e hapura nga NJIF-K (informacioni anonim) | 14 | 18 | +28.57 |
| Rastet e hapura nga Informatat Spontane nga FIU tjera | 1 | 1 | 0.00 |
| Kërkesat për informata | 106 | 113 | +6.60 |
| Projektet e përbashkëta të analizave/hetimeve me Institucionet tjera të zbatimit të ligjit | 1 | 6 | +500.00 |
| Gjithsej Rastet e Hapura | 247 | 318 | +28.74 |

Tabela Nr.13 -Rastet e Hapura 2015-2016




Grafiku Nr.7 -Rastet e Hapura për analizim 2016

4.1.10. Hapja e rasteve me iniciativë të NJIF-K

Detyrat dhe kompetencat e NJIF-K të përcaktuara në nenin 14 të ligjit për PPP/LFT, kanë përshkruar autorizimet e njësisë për pranimin dhe procedimin, marrjen dhe analizimin e raporteve dhe informacioneve.

Ndërmarrja e iniciativave për propozimin e rasteve që ndërlidhen me dukuritë negative të PP/FT, si dhe një qasje sa më proaktive në drejtim të zhvillimeve dhe ngjarjeve të lidhura me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit është ndjekur edhe gjatë vitit 2016. Numri më i madh i rasteve të hapura me vetë-iniciativë ka ardhur nga Informacioni i ofruar vullnetarisht në NJIF-K në lidhje me dyshimet për pastrimin e parave ose financimit të aktiviteteve terroriste. Ka pasur ngritje të numrit të rasteve të hapura bazuar në informacionet nga Media.



Grafiku Nr.8 - Rastet e iniciuara dhe propozuara me iniciative të NJIF-K sipas burimit 2016

| Propozim për hapje te rasteve me iniciative te NJIF-K | 2016 | % |
|--|-----------|----------------|
| Propozim për hapje të rasteve bazuar në analizimin e RTG-ve | 1 | 5.26% |
| Informacioni i marrur nga Institucionet Publike | 4 | 21.05% |
| Propozim për hapje të rasteve bazuar në informacionet e marruara nga mediat | 4 | 21.05% |
| Informacioni spontan i dërguar nga NJIF ndërkombëtare | 1 | 5.26% |
| Inspektim i Pajtueshmërisë | 1 | 5.26% |
| Informacioni i ofruar vullnetarisht NJIF-K-së në lidhje me dyshimet për pastrimin e parave ose financimit të aktiviteteve terroriste | 8 | 42.11% |
| Gjithsej Rastet e Hapura | 19 | 100.00% |

Tabela Nr.14 - Rastet e iniciuara dhe propozuara me iniciative të NJIF-K sipas burimit 2016

4.1.11. Shpërndarja e raporteve të inteligjencës

Shpërndarja dhe shpалosja e inteligjencës financiare tekorganet përgjegjëse për zbatimin e ligjit ose tek ndonjë organ jashtë Kosovës me funksion të ngjashëm me NJIF-K dhe rezultati i analizave për të cilat dyshohet për pastrim të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financim të terrorizmit është një ndër funksionet kryesore të njësisive të inteligjencës. Kjo inteligjencë financiare u mundëson agjencioneve të zbatimit të ligjit të hetojnë krimet e ndërlidhura penale, pastrimin e parave dhe aktivitetet e financimit të terrorizmit. Për më tepër, kjo mund të siguroj një bazë për ndjekjen penale të personave apo subjekteve në të ardhmen nëse shfaqet nevoja për një ndjekje të tillë.

Si rezultat i përpunimit dhe analizimit të raporteve dhe informacioneve të raportuara nga subjektet që janë të obliguara të raportojnë (RTD-ve), si dhe informacioneve tjera dhe atyre që i janë dërguar njësisë si informacion spontan nga NJIF-ët e vendeve të tjera, të dhënat e grumbulluara dhe që është në dispozicion publik dhe që kanë lidhje me pastrimin e parave ose financimin e aktiviteteve terroriste si dhe pas kërkesave për informacion shtesë nga obliguesit ligjor, NJIF-K bën shpërndarjen dhe shpалosjen e informacionit tek autoritetet vendore dhe ato me kompetenca vendore, nëse informacioni i tillë është relevant për hetime në kuadër të




kompetencës së tyre ose tek organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit ose ndonjë organ jashtë Kosovës me funksion të ngjashëm me NJIF-K.

Në vitin 2016, janë referuar tek agjencionet e zbatimit të ligjit 112 raporte të inteligjencës krahasuar me 94 raporte të shpërndara në 2015 dhe 59 në vitin 2014. Kjo tregon për një rezultat në ngritje prej 19 % krahasuar me një vit më parë dhe 90% me 2014. Zhvillime të tilla janë arritur si rezultat i implementimit të dokumenteve strategjike dhe krijimit të planit të performancës dhe resurseve të NJIF-K 2015-2017, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në ngritjen e performacës në vitin 2016 krahasuar me vitet e mëparshme, pavarësisht resurseve të njejta apo edhe zvogëlimit të kapaciteteve të NJIF-K dhe numrit të pamjaftueshëm të zyrtarëve që punojnë në analiza financiare.

Rezultatet e të dhënave statistikore kanë treguar se rreth 93% e raporteve të përgjithshme të shpërndara në vitin 2016 kanë qenë të dyshuara për pastrim të parave ose veprave të ndërlidhura penale, përderisa rreth 7% janë shpërndarë nën dyshimin e financimit të terrorizmit.

Dyshimet kryesore mbi bazën e të cilave janë shpërndarë raportet e inteligjencës kanë qenë të ndërlidhura kryesisht me dyshimet për gjenerim të të ardhurave ngakrim i organizuar, mashtrimi, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, falsifikim i dokumenteve, legalizim i përmbajtjes së rreme, keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, financim i terrorizmit, etj. Për më tepër, raportet e inteligjencës së NJIFshpesh janë të ndërlidhura me dyshimet që përfshijnë të ardhurat e mundshme të gjeneruar nga shmangia tatimore.

Bashkëpunimi për çështje operacionale dhe shkëmbim të informacioneve mbetet përherë më i larti në mes të NJIF-K dhe Policisë së Kosovës. Kjo përfshinë 48% të numrit të gjithëmbarshtëm të raporteve të shpërndara tek ky institucion në vitin 2016, përderisa ka ngritje të numrit të informatave të inteligjencës të referuara në ATK dhe Eulex.




Grafikoni Nr.10 – Raportet e inteligjencës të shpërndara tek autoritetet kompetente 2012-2016

| Raportet e shpërndara të inteligjencës/referuar në | 2016 | % |
|--|------------|-------------|
| Policia e Kosovës | 54 | 48% |
| Prokuroria Speciale | 7 | 6% |
| Administrata Tatimore e Kosovës | 26 | 23% |
| Dogana e Kosovës | 1 | 1% |
| EULEX | 13 | 12% |
| FIU ndërkombëtare | 11 | 10% |
| Gjithsej raportet e shpërndara të inteligjencës | 112 | 100% |

Tabela Nr.15 - Raportet e inteligjencës të shpërndara/referuara në institucione përkatëse 2016

Krahasuar të dhënat e viteve të fundit, të dhënat tregojnë për një shifër prej 192 raporte të inteligjencës financiare të përcjella nga NJIF-K në drejtim të njësive përkatëse të Policisë së Kosovës, shifër kjo e cila e përbën numrin më të madh të raporteve të referuara nga institucionet tjera të zbatimit të ligjit. Rezultatet e analizave të NJIF-K kanë shërbyer si bazë për fillimin e hetimeve të cilat kanë qenë shumë të rëndësishme për rezultatet vijuese të hetimeve dhe ndjekjeve penale. Gjithashtu një numër i konsiderueshëm i raporteve është shpërndarë tek ATK nën dyshimin e evazionit fiskal, vepër kjo e ndërlidhur me pastrimin e parave.

për periudhën pesëvjeçare 2012 – 2016, është paraqitur në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:



Grafikoni Nr.11 – Raportet e shpërndara të inteligjencës 2012-2016

Shpërndarja e raporteve të inteligjencës tek agjencionet tjera vendore dhe ndërkombëtare

| Raportet e shpërndara të inteligjencës/referuar në | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | Gjithsej 2011-2016 |
|--|-----------|-----------|-----------|-----------|------------|--------------------|
| Policia e Kosovës | 25 | 44 | 27 | 42 | 54 | 192 |
| Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës | 1 | 0 | 1 | 9 | 7 | 18 |
| Administrata Tatimore e Kosovës | 17 | 21 | 21 | 23 | 26 | 108 |
| Dogana e Kosovës | 5 | 4 | 2 | 6 | 1 | 18 |
| Agjencia e Kosovës për Inteligjencë | 0 | 0 | 0 | 4 | 0 | 4 |
| Agjencia Kundër Korrupsionit | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 |
| EULEX | 7 | 2 | 2 | 1 | 13 | 25 |
| FIU ndërkombëtare/Informacion Spontan | 0 | 3 | 6 | 8 | 11 | 28 |
| Tjera | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Gjithsej raportet e shpërndara të inteligjencës | 55 | 74 | 59 | 94 | 112 | 394 |

Tabela Nr.16 - Raportet e inteligjencës të shpërndara/referuara në institucione përkatëse 2012-2016


4.1.12. Kërkesat për informata nga institucionet vendore dhe homologët ndërkombëtar

Gjatë këtij viti janë mbajtur takime me zyrtarë nga agjencionete zbatimit të ligjit me qëllim të ndihmës dhe bashkëpunimit në mënyrë reciproke, ndihmës së njëra tjetrës gjatë kryerjes së detyrave të tyre si dhe koordinimit të aktiviteteve në kuadër të kompetencave të tyre në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme. Gjithashtu, shkëmbimi i informative dhe bashkërendimi i veprimeve në mes NJIF-K dhe organeve tjera të zbatimit të ligjit me qëllim të parandalimit dhe hetimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ka qenë i qëndrueshëm edhe gjatë këtij viti.

Zyrtarët ndërlidhës nga Policia e Kosovës dhe Dogana kanë kontribuar në koordinimin e aktiviteteve në kuadër të kompetencave të tyre në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme.

Në vitin 2016, numri i kërkesave për shkëmbim të informacioneve ka qenë 128, kërkesa këto të parashtruara qoftë nga autoritetet hetuese vendore ose nga homologët ndërkombëtar.

Policia e Kosovës vazhdon ta mbaj primatin e numrit më të madh të kërkesave të bëra (me rreth 40%). Ky vit shënon ngritje të numrit të kërkesave nga AKI dhe Dogana e Kosovës.



Grafiku Nr.12 - Kërkesat për informata të pranuar 2016

NJIF-K mbetet e përkushtuar në ngritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar. NJIF-K është e autorizuar që spontanisht ose me anë të kërkesës, të ndajë informacionet me çdo agjenci homologe të huaj që kryen funksione të ngjashme dhe që i nënshtrohet obligimeve të ngjashme për ruajtjen e konfidencialitetit, pavarësisht nga natyra e agjencisë e cila i nënshtrohet reciprocitetit. Informacioni i ofruar përdoret vetëm me miratimin e agjencisë dhe vetëm për qëllime të luftimit të pastrimit të parave, të veprave të ndërlidhura penale dhe të financimit të terrorizmit.

| Kërkesat për informata të pranuar në NJIF-K | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|--|------|------|------|------|------|------|
| Numri i kërkesave për informata të pranuar nga autoritetet vendore | 64 | 103 | 183 | 177 | 110 | 113 |
| Numri i kërkesave për informata të pranuar nga FIU homologe të huaja | 10 | 10 | 7 | 19 | 18 | 16 |
| Gjithsej kërkesat për informata të pranuar në NJIF-K | 74 | 113 | 190 | 196 | 128 | 129 |

Tabela Nr.17 -Kërkesat për informata të pranuar në NJIF-K 2011-2016

Krahas pranimit të kërkesave për shkëmbim të informatave dhe bashkëpunim ndër-institucional, kthimi i përgjigjeve është bërë në afatet sa më të shkurtra kohore. Varësisht nga dyshimi i ngritur për pastrim të parave, financim të terrorizmit ose veprave penale të ndërlidhura bëhet shpërndarja e raporteve të inteligjencës.

| Përgjigje në Kërkesat për Informata | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|---|------|------|------|------|------|------|
| Numri i kërkesave për informata të shpërndara tek autoritetet vendore | 71 | 104 | 174 | 174 | 92 | 91 |
| Numri i kërkesave për informata të shpërndara tek FIU homologe të huaja | 11 | 13 | 5 | 20 | 18 | 14 |
| Gjithsej kërkesat për informata të shpërndara nga NJIF-K | 82 | 117 | 179 | 194 | 110 | 105 |

Tabela Nr.18 - Kërkesat për informata të shpërndara ose përgjigjur nga NJIF-K 2011-2016

4.2. Mbikëqyrja e Pajtueshmërisë

Si një ndër funksionet me rëndësi të Njesisë për Inteligjencë Financiare, mbikëqyrja e pajtueshmërisë përfshinë vlerësimin e përmbushjes së obligimeve ligjore nga ana e subjekteve raportuese në pajtim me ligjin për PPP/LFT.

Kompetencat mbikëqyrëse të mbikëqyrësve për të monitoruar dhe për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat për parandalimin e PP dhe luftimin e FT, duke përfshirë autoritetin për të ndërmarrë inspektime në terren, janë përfshirë në Kapitullin IV i Ligjit për PPP/LFT.

Sa i përket mbikëqyrjes së pajtueshmërisë, ligji i ri përcakton kompetencat mbikëqyrëse edhe për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës sa i përket sektorit financiar. Gjithashtu më këtë kapitull është paraparë edhe mundësia e delegimit të kësaj kompetence nga NJIF tek mbikëqyrësit e tjerë sektorial.

Pas mbikëqyrjes së pajtueshmërisë NJIF-K dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial varësisht nga gjetjet mund të:

- rekomandojnë masat përmirësuese;
- shqiptojnë ndëshkim administrativ; apo
- procedojnë çështjen në procedurë penale.

Për dallim nga legjislacioni i kaluar, tani me këtë ligj është përcaktuar edhe mundësia e mbikëqyrjes së pajtueshmërisë si në vend ashtu edhe nga distanca për NJIF-K dhe BQK.




Gjithashtu, NJIF, BQK, dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial obligohen që të bashkëpunojnë dhe koordinojnë aktivitetet e tyre sa i përket çështjeve që ndërlidhen me:

- planifikimin dhe implementimin e mbikëqyrjes;
- aktivitetet e përbashkëta të mbikëqyrjes në vend dhe në distancë;
- dokumentacionin, vlerësimin, raportimin dhe monitorimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë;
- ndëshkimin administrativ dhe masat e tjera mbikëqyrëse; dhe
- vlerësimin dhe aktivitetet pasuese të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë.

Zbatimi i aktiviteteve mbikëqyrëse për të vlerësuar pajtueshmërinë e subjekteve raportuese me obligimet ligjore, ka vazhduar së zbatuari në mënyrë kontinueale, dhe bazuar në analizën e rrezikut të pajtueshmërisë janë kryer 17 inspektime në teren nga ana e NJIF-K, inspektime këto të kryera në Banka, Auditor Ligjorë, Noter, Agjencitë e Patundshmërive, përdërisa inspektime tjera mbikëqyrëse për banka dhe institucione financiare janë ndërmarrë edhe nga BQK.

Koordinimi i aktiviteteve me mbikëqyrësit sektorial për qëllime të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë të subjekteve raportuese, në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit me BQK-në është realizuar një inspektim i përbashkët me fushëveprim të plotë në Banka. Ndërsa Ligji i ri i definon më qartë kompetencat mbikëqyrëse të NJIF-K, BQK-së dhe autoriteteve tjera mbikëqyrëse.

Inspektimi me fushëveprim të plotë ka përfshirë mbi 70% të inspektimit të gjithëmbarshtëm për vitin 2016, i ndjekur nga inspektimi i kufizuar.



Grafiku Nr.13 – Mbikëqyrja e Pajtueshmërisë sipas llojit të inspektimit 2016

| Viti 2016 | | | | | |
|---------------------------------------|---------------------|------------------------|------------------|--------|----------|
| Subjektet raportuese | Lloji inspektimit | | | | |
| | Fushëveprim i plotë | Fushëveprim i kufizuar | Inspektim Pasues | Ad-Hoc | Gjithsej |
| Banka | // | 3 | // | 1 | 4 |
| Institucione Mikrofinanciare | // | // | // | // | 0 |
| Kompani të Sigurimit | // | // | // | // | 0 |
| Kompani të Sigurimit të Jetës | // | // | // | // | 0 |
| Zyrat e Këmbimit Valutor | // | // | // | // | 0 |
| Agjensione për transfere të parave | // | // | // | // | 0 |
| OJQ | // | // | // | // | 0 |
| Auditor & Kontabilistë | 1 | // | // | // | 1 |
| Noterët | 10 | // | // | // | 10 |
| Agjensionet për patundshmëri | 2 | // | // | // | 2 |
| Gjithsej Inspektimet e Pajtueshmërisë | 13 | 3 | 0 | 1 | 17 |

Tabela nr.19 –Inspektimi i Pajtueshmërisë 2016

Siç vërehet, noterët, bankat kanë pasur fokusin ndër më kryesorët të inspektimeve gjatë vitit 2016, kjo si rezultat i ekspozimit më të madh ndaj fenomenit të pastrimit të parave. Inspektimet etilla janë ndërmarrë në drejtim të vlerësimit të masave parandaluese nga subjektet raportues. Si fokus shtesë në sektorin e patundshmërive dhe ndërtimeve ka qenë edhe menaxhimi i rrezikut dhe implementimi i masave të trajtimit të vlerësimit të rrezikut sektorial në sektorin e ndërtimeve.

| Inspektimi i Pajtueshmërisë 2014 - 2016 | | | |
|---|------|------|------|
| Subjektet raportuese | 2014 | 2015 | 2016 |
| Banka | 9 | 7 | 4 |
| Institucione Mikrofinanciare | 5 | 3 | - |
| Kompani të Sigurimit | 4 | 3 | - |
| Kompani të Sigurimit të Jetës | 2 | - | - |
| Zyrat e Këmbimit Valutor | 7 | 5 | - |
| Agjensione për transfere të parave | 3 | 2 | - |
| OJQ | 5 | 5 | - |
| Auditor & Kontabilistë | - | 1 | 1 |
| Noterët | - | - | 10 |
| Agjensionet për patundshmëri | - | - | 2 |
| Gjithsej Inspektimet e Pajtueshmërisë | 35 | 26 | 17 |

Tabela nr.20 –Inspektimi i Pajtueshmërisë 2014-2016



4.2.1. Ndëshkimet administrative dhe masat për përmirësim

Sfidë e ligjit të kaluar për NJIF-K ka qenë zbatimi i ndëshkimeve administrative për shkak të përcaktimit jo në harmoni me obligimet ligjore për subjektet raportuese. Në Kapitulli 5 të ligjit të ri 05/L-096 janë përcaktuar qartë shkeljet dhe ndëshkimet administrative të kategorizuara në tri nivele: si shkelje shumë të rënda, të rënda dhe të lehta si dhe ndëshkime për tri llojet e shkeljeve si për personat fizik ashtu dhe persona juridik.

Neni 40 Ndëshkimet Administrative

Dështimi nga subjektet raportuese të definuar në nenin 16 të këtij ligji, për t'iu përmbajtur obligimeve ligjore të parashikuara në këtë ligj, që nuk janë vepra penale, përbëjnë shkelje administrative të cilat klasifikohen si shkelje shumë të rënda, shkelje të rënda dhe shkelje të lehta.

Për shkeljet shumë të rënda të përcaktuara në nenin 41, NJIF-K mund të shqiptojë ndëshkim administrativ për subjektin raportues siç definohet në vijim:

- vërejtje publike;
- gjobë në shumën prej pesëdhjetëmijë (50.000) euro, ose dhjetë perqind (10%) të vlerës neto të subjektit raportues, dy(2) herë vëllimin ekonomik të transaksionit, por jo më pak se pesëdhjetëmijë (50.000) euro, si dhe deri në shtatëqindmijë (700.000) euro, për bankat dhe institucionet financiare.
- mund të kërkohet tërheqja e licencës, certifikatës apo autorizimit për funksionimin e subjektit raportues.

Përveç ndëshkimit të zbatueshëm që shqiptohet për subjektin raportues për shkeljet shumë të rënda, një ose më shumë nga ndëshkimet e mëposhtme mund të shqiptohet për personat fizik që janë përgjegjës për shkeljen dhe që mbajnë poste administrative apo menaxhuese në subjektin raportues:

- gjobë për secilin prej tyre prej dhjetëmijë (10.000) euro deri në njëqindmijë (100.000) euro;
- largimi nga detyra, me diskualifikimin nga mbajtja e pozitave administrative apo menaxhuese në të njëjtin subjekt raportues për një periudhë maksimale prej dhjetë (10) vjetësh si dhe largimi nga detyra me diskualifikimin nga mbajtja administrative apo menaxhim në pozicionet në çdo subjekt raportues për një periudhë maksimale prej dhjetë (10) vjetësh.

Për shkelje të rënda të përcaktuara në nenin 43 të këtij ligji, NJIF-K, BQK, si dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial nëse kjo kompetencë i është dhënë sipas paragrafit 5. të nenit 34 të këtij ligji, mund të shqiptojë ndëshkim administrativ siç definohet në vijim, përveç nëse është parashikuar një ndëshkim më i rëndë sipas nenit 41 të këtij ligji:

- vërejtje private
- gjobë në një minimum prej njëzetmijë (20.000) euro ose një shumë maksimale që mund të vendoset deri në pesë perqind (5%) të vlerës neto, shuma e vëllimit ekonomik të

transaksionit plus pesëdhjetë për qind (50 %) të asaj vlere; por jo më pak se njëzet mijë (20.000) euro si dhe deri tridhjetë mijë (30.000) euro

Përveç ndëshkimit të zbatueshëm që shqiptohet për subjektin raportues për shkelje të rënda, një(1) ose më shumë nga dënimet e mëposhtme mund të shqiptohet mbi ata që janë përgjegjës për shkeljen dhe mbajnë poste administrative apo menaxhuese në subjektin raportues:

- vërejtje private;
- vërejtje publike;
- gjobë për secilin prej tyre prej një mijë (1.000) euro deri në njëzet mijë (20.000) euro;
- pezullim i përkohshëm nga detyra për një periudhë që nuk kalon një (1) vit.


Dështimi për të përmbushur detyrimet e specifikuar në këtë ligj dhe që nuk përbëjnë shkelje shumë të rënda ose shkelje të rënda, përbëjnë shkelje të lehta. Për shkelje të lehta NJIF-K, BQK, si dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial nëse kjo kompetence i është dhënë sipas paragrafit 5. të nenit 34 të këtij ligji, mund të shqiptojnë:

- vërejtje private;
- gjobë deri në pesëmbëdhjetë mijë (15.000) euro; dhe
- rekomandime për veprime përmirësuese.

Po ashtu në kapitullin VI është përcaktuar procedura e ndëshkimeve administrative dhe të gjitha detajet e tjera procedurale që kanë të bëjnë me ndëshkimet dhe ankesat.

Nga ajo që u përmend më lartë, në vitin 2016, NJIF-K ka shqiptuar dy gjoba administrative. NJIF-K, pasi ka konstatuar se ekziston shkelje e dispozitave të ligjit për PPP/LFT, ka marr vendimin për shqiptimin e ndëshkimit administrativ për shkeljet për të cilat i është dhënë kompetencë sipas këtij ligji. Gjatë përcaktimit të ndëshkimit administrativ sipas ligjit për PPP/LFT, janë marrë në konsideratë të gjitha rrethanat relevante, duke përfshirë edhe shkallën dhe kohëzgjatjen e mos-përputhshmërisë, shkallën e përgjegjësisë, fuqinë financiare të subjektit raportues, humbjet e shkaktuar si pasojë e shkeljes, shkeljet e mëparshme si dhe nivelin e bashkëpunimit të subjektit raportues.

Me qëllim të ndërmarrjes së masave përmirësuese, NJIF-K gjatë inspektimeve të ndërmarra ka lëshuar gjithsej 94 rekomandime për masat që subjektet raportuese duhet t'i përmirësojnë me qëllim që të jenë në pajtueshmëri të plotë me ligjin.



Grafiku Nr.14 - Rekomandimet për masat përmirësuese 2016

4.2.2. Të dhënat statistikore dhe informatat kthyesë

Njëra ndër sfidat e institucioneve të Republikës së Kosovës deri më tani ka qenë Mbajtja e të Dhënave Statistikore dhe Informatave Kthyesë në lidhje me rastet e veprave penale të përcaktuara në ligjin për PPP/LFT. Ndryshimet e reja ligjore, përkatësisht neni 39 i ligjit në fjalë rregullon këtë fushë.

Të gjitha autoritetet kompetente që kanë përgjegjësi për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe subjektet raportuese obligohen të mbajnë të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse përkatëse për fushën e tyre të përgjegjësisë dhe të vihen në dispozicion të NJIF-K brenda afateve kohore të përcaktuara, për t'i mundësuar që të rishikojë efektivitetin e sistemit kombëtar dhe për të bërë rekomandime.

Në lidhje me harmonizimin e statistikave dhe informatave kthyesë në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, NJIF-K ka filluar së zbatuari këtë aktivitet përmes harmonizimit të statistikave dhe të dhënave me ATK, Doganën, Policinë dhe Prokurorinë Speciale. Përveç kësaj, NJIF-K në periudhën e parë të vitit 2016, ka ndërmarrë veprime për harmonizim të statistikave me subjektet raportuese.

Numri i informatave kthyesë të shkëmbyera është realizuar pjesërisht, ku vetëm ATK bën dërgimin në mënyrë sistematike të informatave kthyesë, duke informuar NJIF-K për secilin rast të përfunduar dhe rezultatet e atij rasti. Ndërsa institucionet tjera, zakonisht këtë e bëjnë në mënyrë periodike (vjetore ose të kohë pas kohe). Vendimet e Gjykatave zakonisht merren nga Koordinatori Kombëtar.

Informatat e marra nga institucionet e zbatimit të ligjit kanë treguar se në këtë periudhë raportuese ka rezultuar se pas dërgimit të raportit të inteligjencës nga NJIF-K në institucionet tjera për hetime të mëtutjeshme të arrihet rezultatet si gjykime dhe dënime për pastrim të parave me vendim të plotfuqishëm të Gjykatave, konfiskim të pasurisë të fituar me vepër penale, ngritje të aktakuzave në lidhje me PP/FT, arrestime nga Policia e Kosovës, kallëzime penale nga Dogana, hetime nga ATK dhe gjetjen e obligimeve tatimore shtesë pas hetimeve etj. Gjatë vitit 2016, numri i informatave kthyesë të pranuar nga NJIF-K ka qenë 13 informata kthyesë të cilat janë përcjell nga agjencionet e zbatimit të ligjit tek NJIF-K në lidhje me rastet e referuara nga NJIF-K në periudhat e kaluara kohore. Administrata Tatimore e Kosovës vazhdon të kthejë informata në mënyrë sistematike. Në vitin 2016 janë përcjell gjithsej 9 informata kthyesë përmes së cilave është njoftuar NJIF-K për rezultatet e hetimeve të ndërmarra në lidhje me rastet e shpërndara nga njësia në vitet e kaluara. Hetimet e ndërmarra nga ATK, kanë treguar se disa nga këto raste ka pasur shmangie tatimore ose mosdeklarim real të qarkullimit që arrijnë në vlerë prej rreth 59,642 Euro pa ndëshkime. Dy nga informatat kthyesë kanë treguar që pas kontrolleve të kryera nuk ka rezultuar me evazion fiskal.



4.3. Aktivitetet e trajnimeve dhe implementimi i Programit të Trajnimeve

Fillimisht, korniza ligjore sa i përket trajnimeve për PPP/LFT është përmirësuar më tej në vitin 2016 me Ligjin 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

Njësia për Inteligjencë Financiare bazuar në paragrafin (1.9) të nenit (14) të Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, tani është e autorizuar që përveç që të organizojë dhe/ose kryej trajnime në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e aktiviteteve terroriste si dhe obligimet e subjekteve raportuese, ajo tani gjithashtu është e autorizuar të bëjë vetëdijesimin dhe sensibilizimin në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit si dhe sa i përket detyrimeve ligjore të subjekteve raportuese.

Këto ndryshime ligjore janë përfshirë me qëllim që përmes vetëdijesimit dhe sensibilizimit të publikut të gjerë të arrihet ngritja e nivelit të parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit.

Në lidhje me vetëdijesimin e subjekteve raportuese përmes fushatave, trajnimeve, seminareve, konferencave etj, NJIF-K ka organizuar dhe mbajtur 5 trajnime me katër sektor nga subjektet raportuese, përmes së cilave janë trajnuar mbi 150 zyrtarë të ndryshëm nga Kompanitë e Sigurimeve, Noterë, Kontabilistë të çertifikuar dhe Auditorë, Institucionet Mikrofinanciare.

Po ashtu, Njësia për Inteligjencë Financiare me qëllim të sigurimit që subjektet raportuese janë informuar lidhur me ndryshimet ligjore të ligjit Nr. 05/L-096 dhe diskutimit të zbatimit praktik të këtyre dispozitave të reja ligjore, përgjatë vitit 2016 ka organizuar disa trajnime të cilat janë paraqitur në tabelën në vijim:

| Data | Subjekti raportues | Nr. i subjekteve | Nr. i pjesëmarrësve | Tema | Mbështetësit |
|------------|---|------------------|---------------------|--|---|
| 25/02/2016 | Kompanitë e sigurimeve | 12 | 14 | Obligimet ligjore sipas Ligjit nr. 03/L-196 dhe 04/L-178 për PPP/PFT | Shoqata e kompanive të sigurimeve të Kosovës |
| 18/06/2016 | Noterët | N/A | 53 | Përgjegjësitë e noterit në parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit sipas ndryshimeve ligjore aktuale | Oda e Noterëve |
| 25/10/2016 | Auditorët dhe Kontabilistët e Çertifikuar | N/A | 83 | Obligimet ligjore të Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve sipas ligjit Nr. 05/L-096 për PPP/LFT | Shoqata e Kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të licencuar |
| 08/11/2016 | Institucionet Mikrofinanciare | 8 | 15 | Ndryshimet ligjore sipas Ligjit Nr. 05/L-096 për PPP/LFT dhe mbikëqyrja e pajtueshmërisë | Shoqata e Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës |
| 10/11/2016 | Kompanitë e Sigurimeve | 11 | 17 | Ndryshimet ligjore sipas Ligjit Nr. 05/L-096 për PPP/LFT | Shoqata e Kompanive të Sigurimeve të Kosovës |

Tabela nr.21 –Trajnimet për subjektet raportuese 2016

Po ashtu gjatë vitit 2016 janë mbajtur trajnime për institucione të sundimit të ligjit dhe institucionet e tjera. Aktiviteti që përfshin ofrimin e trajnimeve për institucionet e zbatimit të ligjit

është realizuar në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat partnere të NJIF-K. Në vitin 2016, zyrtarët e NJIF-K kanë ligjëruar në lidhje me temat e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit në disa trajnime ose punëtori të organizuara nga UNDP, Departamenti Amerikan i Drejtësisë, OPDAT, IGJK, GIZ etj. Pjesëmarrësit në këto trajnime ishin kryesisht Gjyqtarët, Prokurorët, hetuesit policorë etj.

| Data | Institucionet | Numri i pjesëmarrësve | Tema | Mbështetësit |
|--------------------------|---------------------------------|-----------------------|---|---|
| 27/05/2016 28/05/2016 | Gjykata Prokuroria | 35 | Program i Specializuar Trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave- Sesioni I | Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe GIZ |
| 09/09/2016 10/09/2016 | Gjykata Prokuroria | 20 | Program i Specializuar Trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave- Sesioni II | Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe GIZ |
| 09/11/2016 | Prokuroria Policia NJIF-K | 40 | Mbështetja e ndjekjes së suksesshme të veprave penale të korrupsionit përmes ndërtimit, rritjes dhe krijimit të rrjeteve të kapaciteteve hetuese financiare | UNDP, Departamenti Amerikan i Drejtësisë, Zyra për zhvillim dhe trajnim jashtështetrorprokurorial (OPDAT) |
| 17/11/2016 | Zyra Kadastrale Komunale | 4 | Obligimet Ligjore të ZKK sipas Ligjit Nr. 05/L-096 për PPP/LFT | NJIF-K |
| 25/11/2016 26/11/2016 | Gjykata Prokuroria | 25 | Program i Specializuar Trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave- Sesioni III | Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe GIZ |

Tabela nr.22 –Trajnimet për institucionet e zbatimit të ligjit 2016

4.4. Aktivitetet e ngritjes së vetëdijes

Me qëllim të vetëdijesimit dhe sensibilizimit më të gjerë të subjekteve raportuese, akterëve e palëve të tjera të interesit lidhur me ndryshimet ligjore sipas Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, Ministria e Financave në bashkëpunim me NJIF-Kme datë 31/08/2016 kanë mbajtur tryezëpër zbatimin e këtij ligji. Qëllimi i kësaj tryeze ishte që të diskutohen me palët e interesit ndryshimet ligjore dhe modalitetet e zbatimit të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, ligj i cili është i rëndësishëm së veçantë për luftimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlydhura penale dhe financimin e terrorizmit, si dhe funksionimin e rregullt të masave parandaluese nga subjektet raportuese të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në luftimin e këtyre dukurive.Konferenca ishte udhëhequr nga Ministri i Financave.Pjesëmarrëstjerë në këtë konferencë ishin Drejtori i NJIF-K, zëvendësguvernatori i BQK, Drejtori i ATK-së si dhe palët e interesit dhe organizatat ndërkombëtare.

Ministri i Financave Avdullah Hoti bëri të ditur se Qeveria e Kosovës është e angazhuar për implementimin e standardeve ndërkombëtare në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit

të terrorizmit. Andaj, për këtë arsye, ne kemi bërë ndryshimet ligjore me qëllim që të jemi në hap me vendet e tjera në luftën kundër këtyre fenomeneve.

“Për atë që më përket mua si Kryetar i Bordit të NJIF-K, unë do të vazhdojë të përkrah punën e Njësisë për Inteligjencë Financiare dhe së bashku me anëtarët e tjerë të bordit do të punojmë pa rezervë në përcaktimin dhe orientimin e politikave shtetërore sa i përket pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit bazuar në rreziqet e identifikuar, si dhe për ngritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional” tha Ministri Hoti.

Ai bëri të ditur se Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit përcakton masat, autoritetet kompetente dhe procedurat për zbulimin, parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe po ashtu përcakton dispozitat të cilat janë të detyrueshme për të gjitha institucionet dhe njësitë përkatëse të tyre si dhe për të gjithë subjektet jo publike që i nënshtrohen aktiviteteve që mund të ndërlidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Vlen të theksohet se të gjitha institucionet për zbatimin e këtij ligji kanë qenë të përfshira gjatë hartimit të tij si dhe gjithashtu edhe subjektet private që kanë obligime për zbatim të këtij ligji kanë qenë të përfshira në konsultime publike.

“Tani, suksesi në zbatimin e këtij ligji varet nga përkushtimi dhe bashkëpunimi i të gjitha institucioneve të cilat janë të mandatuara për luftimin e këtyre dukurive si dhe subjektet raportuese të cilat gjithashtu kanë obligime për zbatimin e këtij ligji. Siç e dini, pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit janë fenomen global dhe nuk njohin kufij kombëtarë, pasi tregjet financiare në ditët e sotme janë të ndërlidhura edhe mundësitë dhe metodat e organizatave kriminale për legalizimin e pasurisë së paligjshme janë të mundshme, andaj e gjithë kjo kërkon reagim dhe veprim të përbashkët si në nivel kombëtar ashtu dhe atë ndërkombëtarë”, tha ministri Avdullah Hoti në fund të kësaj tryeze.

Drejtori i Njësisë për Inteligjencë Financiare Dardan Nuhiu tha se *“ Është vlerësuar si qenësore që të kemi bazën e duhur ligjore dhe të sigurohemi, që sektori publik ashtu edhe sektori privat të kenë mjetet dhe ndërmarrin masa të duhura në mënyrë që të parandalojmë dhe luftojmë pastrimin e parave dhe financimin e terrorizimit. Ligji i ri ofron një bazë të qëndrueshme ligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizimit në harmoni me standardet ndërkombëtare të FATF-së dhe direktivën e re të BE-së dhe Parlamentit Evropian për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar, me qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit. Andaj, ky ligj do ti shërbej edhe objektivit të Qeverisë së Republikës së Kosovës në integrimet evropiane”.*

“Sistematizimi i dispozitave ligjore ka eliminuar dhe limituar pengesat në zbatimin e legjislacionit dhe ka qartësuar detyrat dhe kompetencat e NJIFK-së, si Institucion përgjegjës për parandalimin e këtyre dukurive, si dhe kompetencat e Bordit që të kryej funksionin e mekanizimit përgjegjës, koordinues për përcaktimin dhe orientimin e politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave të bazuar në rreziqet e identifikuar si dhe ngritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional në pajtim me qëllimet e këtij Ligji”, shtoi drejtori Nuhiu



Për më tepër, me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve të institucioneve të zbatimit të ligjit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe trajnimi i subjekteve raportuese, NJIF-K në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat partnere të saj, zyrtarët nga NJIF-K në vitin 2016 kanë ligjëruar në lidhje me temat e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit në disa trajnime ose punëtori të organizuara nga UNDP, Departamenti Amerikan i Drejtësisë, OPDAT, IGJK, GIZ etj. Pjesëmarrësit në këto trajnime ishin kryesisht Gjyqtarët, Prokurorët, hetuesit policorë, analistët e NJIF-K, etj.

Përveç kësaj, në lidhje me vetëdijesimin e subjekteve raportuese përmes fushatave, trajnimeve, seminareve, konferencave etj, NJIF-K ka organizuar dhe mbajtur 5 trajnime me katër sektor nga subjektet raportuese, përmes së cilave janë trajnuar zyrtarë të ndryshëm të subjekteve raportuese nga sektori privat.

Gjithashtu takimet me subjektet raportuese për qëllim të informimit të tyre si dhe forma tjera të takimeve kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2016. Përveç takimeve individuale, NJIF-K ka mbajtur takime edhe në kuadër të shoqatave sipas sektorëve specifik.

4.5. Ngritja e kapaciteteve të NJIF-K

4.5.1. Teknologjia Informative



Me 22-25 Mars 2016, në Vjenë të Austrisë është mbajtur Takimi i 3-të ndërkombëtar i grupit të përdoruesve të goAML. Takimi është organizuar nga UNODC në koordinim me udhëheqësin e grupit të përdoruesve FIU Holandë. Pjesëmarrës në këtë takim ishin 61 përfaqësues të FIU-ve dhe organizatave tjera nga 47 vende.

Çështjet kryesore të diskutuara nga Komuniteti i Përdoruesve kishin të bënin me rolin dhe bashkëpunimi ndërmjet GPML, ITS, strategjitë afatmesme dhe afatgjata për qeverisjen e goAML, priorizimin dhe zhvillimin e karakteristikave të reja funksionale, etj. Parimet e punës së grupit të përdoruesve do të udhëhiqen nga parimi i transparencës, llogaridhënies, fleksibilitetit dhe qëndrueshmërisë.

Komuniteti i përdoruesve të goAML është në rritje e sipër. Në takimet paraprake ka pasur disa zhvillime të rëndësishme lidhur me kahjen e zhvillimit të këtij softueri, si produkt i UNODC. Zhvillimi i sistemit goAML është menduar të ketë qasje regjionale.

4.5.2. Trajnime, konferenca, seminare dhe takime tjera të ndjekura nga personeli i NJIF-K

Ngritjes së vazhdueshme profesionale të stafit të NJIF-K i është kushtuar rëndësi e veçantë edhe gjatë vitit 2016, që për fokus ka pasur ngritjen e aftësive për analiza financiare, hetime financiare, konfiskim të pasurisë, etj. Kjo ngritje në aspektin profesional është bërë përmes pjesëmarrjes së stafit të NJIF-K në trajnime dhe seminare të ndryshme, ku kryesisht këto trajnime, zyrtarët nga njësia i kanë vijuar së bashku me zyrtarët e tjerë nga institucione tjera të zbatimit të ligjit në vend dhe jashtë vendit.

Pjesëmarrja në trajnime të specializuara nga stafi i NJIF-K është realizuar përmes mbajtjes së 30 trajnimeve, seminareve, konferencave, punëtorive të ndryshme të organizuara nga institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare. Krahasuar me vitin e kaluar ka një ngritje prej rreth 7% të trajnimeve të mbajtura në vitin 2016.

• **Takimi i tretë i përdoruesve të goAML, Vienë - Austri, 22-25 mars 2016**

Me 22-25 mars 2016, në Vjenë të Austrisë është mbajtur Takimi i 3-të ndërkombëtar i grupit të përdoruesve të goAML. Takimi është organizuar nga UNODC. Pjesëmarrës në këtë takim ishin dy përfaqësues nga NJIF-K, përderisa prezent në takim ishin edhe 61 përfaqësues të FIU-ve dhe organizatave tjera nga 47 vende të ndryshme.

• **Hetimet e integruara financiare, Prishtinë**


Trajnimi është organizuar nga Policia e Kosovës dhe Projekti i Binjakëzimit i financuar nga BE dhe që implementohet nga shteti i Gjermanisë dhe Hungarisë dhe ishte mbajtur në Prishtinë me 12 deri më 15 prill. Tre zyrtarë nga NJIF-K kanë marrë pjesë në këtë trajnim.

• **Luftimi i ekonomisë jo formale, Prishtinë**

Me 26 deri 28 prill 2016, në Prishtinë është organizuar trajnimi për me titull "Luftim i Ekonomisë jo formale", organizuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës. Trajnimi përfshiu përfaqësues nga NJIF-K, Prokuroria, Gjykata, Policia, etj.

• **AFCOS Seminar - European Anti-Fraud Office, Tiranë, Shqipëri, 01-03 qershor 2016**

Në muajin qershor një zyrtarë nga NJIF-K ka marrë pjesë në Seminarin AFCOS - European Anti Fraud Office të mbajtur në Tiranë, Shqipëri.



- **Workshopsonpublic/private informationsharingandinternationalcooperation, Ohër, Maqedoni, 13 dhe 14 qershor 2016**

Në Konferencën për lansimin e projektit "iPROCEEDS" për bashkëpunim kundër krimit kibernetikë në Evropën Juglindore dhe Turqi, te mbajtur ne Ohër, me 13-14 qershor 2016, e organizuar nga Këshilli i Evropës.

Pjesëmarrës ishin anëtarët e projektit nga të gjitha shtetet përfituese duke përfshirë edhe Kosovën, si dhe përfaqësues nga Institucione te ndryshme po nga shtetet përfituese si dhe ekspert nga BE-ja. Delegacioni nga Kosova ishte i përbërë nga udhëheqësit e Sektorit të Krimeve Kibernetike, Divizionit të Trajnimeve dhe Divizionit për Krime Financiare nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, një Prokuror nga Prokuroria Themelore ne Prishtine, një përfaqësues nga Njësia për Inteligjencës Financiare, një përfaqësues nga Instituti Gjyqësor si dhe një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë.

Në këtë punëtori dy ditore u diskutua për aktivitetet e projektit si dhe situatën aktuale dhe hapat qe duhet te ndërmerren me qellim te pengimit te pastrimit të parave përmes internetit, pastaj bashkëpunimi publiko privat dhe u kërkua një bashkëpunim ma i fuqishëm në të ardhmen, si nga përfaqësues të institucioneve financiare, por edhe atyre të dhënies së shërbimeve, me qellim të arrijtes së rezultateve më të mira.

- **Kontestet e deklarimit të mjeteve monetare në pikat doganore të Kosovës**

Me 14/07/2016, në Prishtinë është organizuar trajnimi për me titull "Kontestet e deklarimit të mjeteve monetare në pikat doganore të Kosovës", organizuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës. Trajnimi përfshiu përfaqësues nga NJIF-K dhe institucionet zbatuese të ligjit etj.

- **Konfiskimi ndërkufitar i pasurive, organizuar nga GIZ, mbajtur në Prevallë, 07-08 shtator 2016**

Organizuar nga GIZ Gjermani, në muajin shtator 2016 në Prevallë, Kosovë është mbajtur seminari dyditor në lidhje me konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme. Në mesin e pjesëmarrësve nga institucionet vendore të zbatimit të ligjit, ishin edhe dy zyrtarë të NJIF-K.

- **Konferencandërkombëtare për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm, Prishtinë**

Nën organizimin e OCBE dhe MPB-së, më 27 dhe 28shtator, është mbajtur konferencë ndërkombëtarepër luftimin e ekstremizmit të dhunshëm. Në këtë konferencë,përfaqësuesit nga vende të ndryshme, prezantuan gjendjen e tyre dhe sfidat përkatëse në lidhje me masat kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe financimit të terrorizmit. Mbi 200 pjesëmarrës ishin prezent në këtë ngjarje.



- **Mbështetja e ndjekjes së suksesshme të veprave penale të korrupsionit përmes ndërtimit, rritjes dhe krijimit të rrjeteve të kapaciteteve hetuese financiare, Ambasada Amerikane/USDoJ, OPDAT/ UNDP, 08-10 nëntor 2016, Prizren**

Nga data 14 deri më 17 shtator nën organizimin e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, përkatësisht Institutit të Mbrojtjes për Studime të Drejtës Ndërkombëtare, është organizuar trajnimi me titull "Aspektet ligjore të luftimit të korrupsionit", pjesëmarrës në të cilin kanë qenë përfaqësues nga institucionet relevante të kësaj fushe në vend. Ekspert me përvojë nga SHBA kanë ligjërue në këtë trajnim.

- **OctopusConference, Strasburg,16-18 nëntor 2016**

Me 16-18 nëntor 2016 zyrtarë nga NJIF-K kanë marrë pjesë në Konferencën globale "Octopus" për bashkëpunim kundër krimit kibernetikë, të mbajtur ne Strasburg, e organizuar nga Këshilli i Evropës. Pjesëmarrës ishin 300 ekspertë nga sektori publik dhe privat, si dhe organizata ndërkombëtare dhe jo-qeveritare. Në këtë Konferencë u diskutua: për zbatimin e Konventës së Budapestit për Krimin Kibernetikë, për ngritjen e kapaciteteve për luftë kundër këtij lloj krimi, politikat dhe iniciativat për krimin Kibernetikë nga Organizatat Ndërkombëtare dhe sektori privat, radikalizmin përmes internetit, për trajtimin e provave elektronike, terrorizmin, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar dhe rritjen e rolit të pikës së kontaktit 27/4, rritjen e krimit kibernetikë, mashtrimin përmes internetit, pastrimin e parave përmes internetit.

Dhe në fund të gjithë pjesëmarrësit nga të gjitha Kontinentet shprehën një interes të përbashkët për qasje sa më efektive kundër kërcënimit në rritje të krimit kibernetikë, po ashtu u theksua se masat kundër krimit kibernetikë janë një përgjegjësi e përbashkët dhe duhet të bazohen në parime të përbashkëta për një udhëzim të qartë për qeveritë dhe organizatat, për të siguruar angazhim politik si dhe për të lehtësuar bashkëpunimin në luftë kundër këtij lloj krimi.

- **Punëtorja në lidhje me funksionalizimin e plotë të sistemit për menaxhim të rasteve me prioritet, Durrës, Shqipëri**

Organizuar nga MIE dhe mbështetur nga GIZ Gjermani, në muajin Nëntor 2016 në Shqipëri, Kosovë është mbajtur Punëtorja dyditore në lidhje me sistemin për menaxhimin e rasteve me prioritet si pjesë e mekanizmit për shënjestrimin e rasteve. Në mesin e pjesëmarrësve nga institucionet vendore të zbatimit të ligjit, ishte edhe një zyrtarë të NJIF-K.

- **Trainingonnew AMLD Directive: Directive (EU) 849/2015 and its current amendments in the Council of the EU**

Bashkorganizuar nga NJIF-K dhe DIEKP, Ministria e Financave dhe mbështetur nga UNDP, më 24/11/2016 është mbajtur trajnim me gjithë stafin profesional të NJIF-K në lidhje me Direktivën e re të BE dhe ndryshimet që pritet të bëhen në kuadër të kësaj direktive. Një ekspert nga UNDP ka ligjërue temat me interes për NJIF-K dhe legjislacionin aktual, duke

përfshirë Pronarin Përfitues, Identifikimin e Personit të Ekspozuar Politikisht (PEP), çështje tjera të direktivës, masat kundër financimit të terrorizmit.

- **Targeting Crime Proceeds on the Internet in South-Eastern Europe and Turkey, Tiranë, Shqipëri, 25 nëntor 2016**

Në kuadër të projektit iPROCEEDS të Këshillit të Evropës NJIF-K ishte ftuar nga Këshilli i Evropës që të marr pjesë në punëtorin një ditore për mekanizmat e raportimit: Praktikën më të mira ndërkombëtare, e cila u mbajt në Tiranë, Shqipëri, në datë 25 nëntor 2016. Pjesëmarrës ishin nga të gjitha shtetet e regjionit, të cilët janë pjesë të projektit iPROCEEDS.

- **IREITOX Academy National Seminar - Establishing a National Early Warning System, Prishtinë, 29-30 nëntor 2016**

Organizuar nga MPB dhe ekspertë nga EMCDDA kanë mbajtur seminar dy ditorë në Prishtinë, ku pjesëmarrës ishte një përfaqësues nga NJIF-K dhe zyrtarë nga institucionet tjera .

- **Punëtori për vlerësimin e Strategjisë dhe planit të veprimit kundër Terrorizmit**

NJIF-K si pjesë e sekretariatit dhe grupeve punuese për implementimin e planit të veprimit të Strategjisë kundër Terrorizmit, nga 6 deri më 8 dhjetor kanë mbajtur takim në lidhje me implementimin e strategjisë dhe vlerësimin e shkallës së implementimit të saj. Punëtorja është mbështetur nga OSBE.

- **Punëtorja për vlerësimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Narkotikeve 2012-2017**

Ngjashëm si më lartë nën mbështetjen e OSBE dhe organizuar nga MPB, NJIF-K si pjesë e sekretariatit dhe grupeve punuese për implementimin e planit të veprimit të Strategjisë kundër Narkotikëve, nga 6 deri më 8 dhjetor ka marrë pjesë në takimin në lidhje me implementimin e strategjisë dhe vlerësimin e shkallës së implementimit të saj.

- **Punëtorja për vlerësimin e planit të veprimit të strategjisë kundër krimet të organizuar 2012-2017**

Më 8 dhe 9 dhjetor 2016, në Pejë është mbajtur punëtorja për vlerësimin e planit të veprimit të strategjisë kundër krimet të organizuar 2012-2017. Kjo punëtorja është organizuar nga MPB dhe është mbështetur nga OSBE.

- **Workshop on inter-agency and international cooperation for search, seizure and confiscation of online crime proceeds, Prishtinë**

Me datë 8-9 dhjetor 2016, është zhvilluar një punëtorja e cila i është dedikuar bashkëpunimit ndërinstitucional. Në këtë punëtorja janë shkëmbyer përvojat e institucioneve tona dhe është dal me një konkludim se ekziston një bashkëpunim i mirë por lëhapësirë për t'u përmirësuar

pasi që krimet kibernetike janë një fenomen i cili dita, ditës ndryshon. Kjo punëtori është organizuar në kuadër të projektit të BE&KiE "iPROCEEDS".

- **Punëtorja "Pastrimi i parave dhe rreziqet nga teknologjia e re" , Bukuresht, Rumani, 12-13 dhjetor**

Në kuadër të projektit iPROCEEDS të Këshillit të Evropës, NJIF-K ishte e ftuar që të marr pjesë në mbledhjen e Komitetit Drejtues të Projektit. Po ashtu gjatë kësaj mbledhje u mbajt edhe punëtorja "Pastrimi i parave dhe rreziqet nga teknologjia e re". Pjesëmarrës ishin nga të gjitha shtetet e regjionit, të cilët janë pjesë të projektit iPROCEEDS.

Gjatë punëtorisë u fol për rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër pastrimit të parave, sidomos për bashkëpunimin ndërkombëtar në mes të Njësive për Inteligjencës Financiare dhe mënyrën e përdorimit të këtyre informata të inteligjencës nga agjensionet tjera.

Gjithashtu në këtë punëtori përveç eksperteve të ndryshëm nga Luksemburgu, Sllovenia, Rumania, OSBE-ja, Kombet e Bashkuara, Polonia, të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e IPA-së për shtetet përfituese të projektit.



5. BASHKËPUNIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR

5.1. *Bashkëpunimi dhe koordinimi vendor*

NJIF-K përmes mekanizmit raportues dhe implementues ka mbështet Ministrinë e Financave në përpilimin e raporteve mbi situatën për parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë.

Mbështetja dhe ofrimi i trajnimeve për institucionet e zbatimit të ligjit është arritur falë bashkëpunimit me institucionet tjera. Edhe këtë vit ka vazhduar publikimi i ngjarjeve dhe dokumenteve tjerë, kjo me qëllim të përmirësimit të parandalimit e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe njohuritë publike rreth rolit të NJIF-it.

Në lidhje me ndërmarrjen e vlerësimit të rrezikut sektorial dhe specifik për fushat përkatëse me fokus në sektorët dhe fushat më të rrezikuara, NJIF-K në bashkëpunim me Projektin BE, do të fillojnë implementimin e realizimit të vlerësimit të rrezikut sektorial në sektorët e identifikuar si më të cenueshmit.

Në lidhje me promovimin e bashkëpunimit dhe koordinimin ndërmjet institucioneve si dhe rritjes së bashkëpunimit me institucionet vendore të zbatimit të ligjit, gjatë kësaj periudhe janë mbajtur takime me zyrtarë nga agjencionet e zbatimit të ligjit me qëllim të ndihmës dhe bashkëpunimit në mënyrë reciproke, ndihmës së njëra tjetrës gjatë kryerjes së detyrave të tyre si dhe koordinimit të aktiviteteve në kuadër të kompetencave të tyre në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme. Po ashtu, është bërë shkëmbimi i informative dhe bashkërendimi i veprimeve në mes NJIF-K dhe organeve tjera të zbatimit të ligjit me qëllim të parandalimit, pengimit dhe hetimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Janë mbajtur takime me hetues policor dhe prokuror nga PSRK në lidhje me bashkëpunimin dhe koordinimin e rasteve në proces. Për më tepër është bërë shkëmbimi i informatave dhe bashkërendimi i veprimeve në mes NJIF-K dhe organeve tjera të zbatimit të ligjit me qëllim të parandalimit, pengimit dhe hetimit të ekstremistëve të dhunshëm apo terroristëve.

Zhvillimi i mekanizmave të përbashkët për shkëmbim të informacioneve mes agjencioneve të cilat kanë përgjegjësi në parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit financiar ka vazhduar tutje. Mbi 90% e shkëmbimit të informatave bëhet përmes sistemit elektronik. Institucionet janë siguruar që shkëmbimi i tillë i informacioneve të bëhet përmes një sistemi të sigurt të komunikimit duke përdorur kanale të sigurt për shkëmbimin e të dhënave. Një qasje e tillë e lejon shkëmbimin e shpejtë të informacionit të caktuar e cila e rrit efikasitetin e punës në kuadër të kompetencave ligjore të institucioneve kompetente.

Në mënyrë që të kryejnë detyrat e saj NJIF-K duhet t'i lejohet qasje në kohë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të të dhënave financiare, administrative dhe të sigurt të informatave dhe dokumentacionit e cila do të kontribuoj në analizën më të shpejtë të RTD-ve. Rrjedhimisht, NJIF-K ka qasje të tërthortë dhe drejtpërdrejt në disa nga të dhënat e institucioneve vendore, përderisa të dhënat tjera mbliidhen edhe me anë të një kërkesë me shkrim. Rritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të NJIF-K është synuar të arrihet përmes ndërlidhjes së sistemeve të NJIF-K me



agjensionet tjera dhe qasjes në bazat e të dhënave, ku NJIF-K dhe DK kanë përfunduar studimin e fizibilitetit për ndërlidhjen e databazave, si dhe janë akorduar për qasjen e NJIF-K në databazën e Doganës.

Sfidë për të ardhmen mbetet shkëmbimi i informatave kthyesë dhe harmonizimi i të dhënave statistikore.

Numri i kërkesave për shkëmbim të informatave ka qenë i përafërt me vitin e kaluar. Policia e Kosovës mban numrin më të madh të parashtrimit të kërkesave për shkëmbim të informatave, përdërisa ka rritje të theksuar të numrit të kërkesave nga AKI.

| Institucionet parashtruese të kërkesës | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|--|-----------|------------|------------|------------|------------|------------|
| Policia e Kosovës | 21 | 28 | 57 | 91 | 52 | 45 |
| AKI | 0 | 5 | 14 | 23 | 19 | 28 |
| EULEX | 16 | 15 | 8 | 11 | 7 | 5 |
| Prokuroria Speciale e Kosovës | 4 | 4 | 1 | 6 | 3 | 1 |
| Prokuroria e Shtetit | 0 | 0 | 5 | 6 | 3 | 0 |
| Administrata Tatimore e Kosovës | 1 | 2 | 20 | 7 | 2 | 0 |
| Dogana e Kosovës | 18 | 44 | 61 | 25 | 15 | 22 |
| ILECU | 0 | 2 | 15 | 6 | 6 | 6 |
| Tjera | 4 | 3 | 2 | 2 | 3 | 6 |
| Gjithsej | 64 | 103 | 183 | 177 | 110 | 113 |

Tabela nr.23 - Kërkesat për informata (IRD) të parashtruar nga institucionet bashkëpunuese të NJIF-K 2011-2016

5.1.1. Bashkëpunimi me Agjensionet e Zbatimit të Ligjit dhe institucionet tjera

Kompetencat e Prokurorisë në lidhje me Veprat penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të përshkruara në nenin 56 dhe 57 të Ligjit për PPP/LFT hyjnë në kompetencën ekskluzive të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, të themeluar me Ligjin mbi Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Veprat tjera penale të përshkruara në këtë ligj hyjnë në kompetencën e prokurorëve të shtetit siç përshkruhet në Ligjin mbi Prokurorin e Shtetit dhe në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

Për më tepër NJIF-K është pjesë e grupit për zbulimin dhe shënjestrimin e rasteve të krimeve të rënda, grup ky i udhëhequr nga PSRK dhe me një pjesëmarrje edhe nga institucionet tjera të zbatimit të ligjit. Kjo ka ndikuar që NJIF-K dhe Prokuroria Speciale të kenë bashkëpunim më të theksuar në çështje operacionale në proces dhe veprime tjera me interes të përbashkët.

Të dhënat e mekanizmit përcjellës ndërinstitucional për harmonizimin e raporteve statistikore tregojnë se nga periudha paraprake (2015) në vitin 2016, nëpër prokurori janë bartur (Ngarkesa me lëndë) 31 kallëzime penale me 76 persona për veprën penale të grupit të Pastrimit të parasë, ndërsa gjatë vitit 2016 janë pranuar në punë 4 kallëzime penale me 7 persona, që



rezulton se në vitin 2016 prokuroritë kanë pasur në punë gjithsej 35 kallëzime penale me 83 persona⁴.

Prokuroritë gjatë vitit 2016 kanë zgjidhur 6 kallëzime penale me 17 persona dhe në fund të periudhës (2016) kanë mbetur të pazgjidhura 29 kallëzime penale me 66 persona.

Prokuroria Speciale gjatë vitit 2016 ka zgjidhur 6 kallëzime penale me 17 personave të përfshirë në kallëzimet penale për veprën penale të grupit të Pastrimit të parasë (shih figurën 49). Mënyra e zgjidhjes së rasteve për 17 persona pasqyrohet në vazhdim: - Për 3 persona apo 17.64% janë hedhur kallëzimet penale; - Për 11 persona apo 64.70% janë pushuar hetimet; - Për 3 persona apo 17.64% janë ngritur aktakuza pas zhvillimit të hetimeve.

Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës mbetet ndër më intensivët në kuadër të këtij bashkëpunimit ndërinstitucional. Të dhënat tregojnë se në vitin 2016 ka pasur ngritje prej 29% të numrit të raporteve të inteligjencës financiare të përcjella nga NJIF-K në drejtim të njësisve përkatëse të Policisë së Kosovës. Në pesë vitet e fundit, të dhënat tregojnë për një shifër prej 192 raporte të inteligjencës financiare të shpërndara nga NJIF-K tek Policia e Kosovës për hetime të mëtutjeshme.

Bashkëpunimi në shkëmbim të informacioneve mbetet përherë më i larti në mes të NJIF-K dhe Policisë së Kosovës.


Numri i raporteve të inteligjencës të shpërndara në ATK dhe Doganë ka mbetur i qëndrueshëm me vitet e kaluara, raporte këto të shpërndara përkritazi me dyshimet për evazion fiskal ose kontrabandë.

Informatat kthyesë të përcjella në mënyrë sistematike nga ATK kanë treguar se nga gjithsej dhjetë (10) informata kthyesë, në tetë (8) prej tyre ka rezultuar me gjetjet se kishte evazion fiskal dhe nga ATK është konstatuar se subjektet e hetuara janë ngarkuar me tatimin që është dashur ta deklarojnë ose paguajnë në periudhat e kaluara.

Shkëmbimi i informatave dhe bashkëpunimi me AKI ka shënuar progres nga viti në vit. Në vitin 2016 është rritur numri për 47% i kërkesave për informata të parashtruara nga AKI për NJIF-K. Bashkëpunimi më i theksuar me këtë institucion të sigurisë nacionale është përqendruar kryesisht tek dyshimet për krim të organizuar dhe financim të terrorizmit.

NJIF-K dhe EULEX kanë zhvilluar bashkëpunim të ngushtë në sfera të ndryshme përfshirë ato më të theksuara luftimi i PP/FT dhe veprave tjera të ndërlidhura dhe krimin e organizuar. Prokurorët e Prokurorisë Speciale dhe zyrtarë tjerë nga Eulex kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm në rastet specifike duke ofruar profesionalizmin dhe ekspertizën financiare nga zyrtarët e NJIF-K. Kjo ka bërë që të ketë ngritje të theksuar të numrit të raporteve të inteligjencës të shpërndarë tek ky autoritet i zbatimit të ligjit.

⁴ Raporti Vjetor (2016) i Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për Harmonizimin e Statistikave për Veprat Penale Karakteristike



5.2. Bashkëpunimi me homologët e huaj dhe Grupin Egmont

5.2.1. Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve

Ngritja e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave me NJIF homologe ndërkombëtare ka shënuar progres edhe gjatë vitit 2016, kjo me qëllim të parandalimit dhe zbulimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe veprave të ngjashme penale. Janë kryer vizita mes Njësive homologe si dhe është planifikuar mbajtja e takimeve ndërkombëtare dhe nënshkrimi i MM-ve. Është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me FIU Lituania. Të dhënat tregojnë për një numër të qëndrueshëm të shkëmbimit dhe ndarjes spontane të informacionit me NJIF homologe. NJIF-K është duke vazhduar përpjekjet për anëtarësim në organizata ndërkombëtare të kësaj fushe.

Shkëmbimi ndërkombëtar i inteligjencës financiare me qëllim të parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ka qenë i përafërt me vitet e kaluara. Gjithashtu parashtimi i kërkesave për informata drejtuar NJIF-ve ndërkombëtar është i qëndrueshëm. Ka vazhduar përpjekja e NJIF-K për shkëmbim të shpejtë dhe konstruktiv i informacionit duke zvogëluar ditët mesatare të kthimit të përgjigjeve.

| Bashkëpunimi ndërkombëtar | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|---|------|------|------|------|------|
| KËRKESAT E PRANUARA DHE SHPËRNDARA | | | | | |
| Kërkesat e FIU-ve të huaja të dërguara në NJIF-K | 10 | 7 | 19 | 18 | 16 |
| Përgjigje në Kërkesat e huaja të shpërndara nga NJIF-K | 13 | 6 | 20 | 18 | 14 |
| Kërkesat e huaja të refuzuara nga NJIF-K | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Numri mesatar i ditëve për t'iu përgjigjur kërkesave nga NJIF-ët e huaj | 33 | 26 | 29 | 23 | 16 |
| Ndarja spontane e informacioneve | | | | | |
| Informacioni Spontan i pranuar nga NJIF-K | // | 2 | 1 | 1 | 1 |
| Informacioni Spontan i shpërndarë nga NJIF-K | // | 3 | 6 | 8 | 11 |

Tabela nr.24 – Shkëmbimi ndërkombëtar i informatave 2012-2016

5.2.1.1. Kërkesat e pranuar dhe shpërndara për shkëmbim të informacionit ndërkombëtar

NJIF-K është në gjendje që të kryejë analiza financiare në emër të homologëve të huaj për informatat që janë në dispozicion publik dhe bazat e veta të të dhënave (duke përfshirë informacionin e ndërlidhur me RTD, RTG, AIF etj). NJIF-K gëzon të drejtën për të kërkuar dhe për të pranuar nga organet publike ose qeveritare të dhëna, dokumente dhe informata që i duhen me qëllim që të ushtrojë detyrat që dalin nga ligji PPP/LFT, si dhe mund që spontanisht ose me anë të kërkesës të ndajë informacionin me agjencinë homologe të huaj që kryen funksione të ngjashme dhe që i nënshtrohet detyrimeve të ngjashme për ruajtjen e konfidencialitetit, pavarësisht prej natyrës së agjencisë që i nënshtrohet reciprocitetit. Në të

njëjtën kohë, Ligji për PPP/LFT i lejon NJIF-K që të kërkojë informacione nga institucionet financiare në bazë të një kërkesë nga një NJIF e huaj.

Shkëmbimi ndërkombëtar i inteligjencës financiare me qëllim të parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ka qenë i përafërt me vitin e kaluar. Rreth 56% e kërkesave janë bërë nga vendet e rajonit, përdërisa 44% nga FIU e Bashkimit Evropian.

Kërkesave të parashtruara nga njësitë homologe, NJIF-K u është përgjigjur në mënyrë efektive dhe në kohë sa më të shkurt të mundshme. Të dhënat tregojnë që NJIF-K nuk ka refuzuar ndonjë kërkesë për t'u përgjigjur.

| Kërkesat e NJIF-ve të huaja të dërguara në NJIF-K | 2016 | Përgjigje në Kërkesat e huaja të shpërndara nga NJIF -K | 2016 |
|---|-----------|---|-----------|
| NJIF Shqipëri | 2 | NJIF Shqipëri | 1 |
| NJIF Bullgari | 1 | NJIF Bullgari | 1 |
| NJIF Finlandë | 1 | NJIF Finlandë | 1 |
| NJIF Maqedoni | 3 | NJIF Maqedoni | 3 |
| NJIF Mali i Zi | 3 | NJIF Mali i Zi | 3 |
| NJIF Norvegji | 3 | NJIF Norvegji | 2 |
| NJIF Zvicër | 2 | NJIF Zvicër | 2 |
| NJIF Holandë | 1 | NJIF Holandë | 1 |
| Gjithsej | 16 | Gjithsej | 14 |

Tabela nr.25 – Kërkesat e FIU-ve të huaja të dërguara në NJIF-K 2016

Tabela nr.26 – Përgjigje në Kërkesat e huaja të shpërndara nga NJIF-K 2016



Vitet e fundit shkëmbimi ndërkombëtar i informatave është bërë kryesisht me vendet e rajonit (Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, Greqi, Slloveni, Bullgari,etj) dhe vendet e Bashkimit Evropian (Gjermani, Finlandë, Suedi, Norvegji, Zvicër, Holandë,etj), por duke përfshirë edhe vendet tjera jashtë kontinentit evropian përfshirë këtu Arabinë Saudite, Ganën, etj.

| Përgjigje në Kërkesat e huaja të shpërndara nga NJIF-K | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|--|-----------|----------|-----------|-----------|-----------|
| NjIF Maqedoni | 5 | 1 | 3 | 4 | 3 |
| NjIF Mali i Zi | 6 | 5 | 3 | - | 3 |
| NjIF Kroaci | 1 | - | 1 | - | |
| NjIF Holandë | 1 | - | - | 1 | 1 |
| NjIF Shqipëri | - | - | 1 | 3 | 1 |
| NjIF Bosne dhe Hercegovinë | - | - | - | - | - |
| NjIF Gjermani | - | - | - | - | - |
| NjIF Austri | - | - | 1 | - | - |
| NjIF Bullgari | - | - | 2 | - | 1 |
| NjIF Slloveni | - | - | 2 | 2 | - |
| NjIF Zvicër | - | - | 2 | 1 | 2 |
| NjIF Hungari | - | - | - | 2 | - |
| NjIF Turqi | - | - | - | 1 | - |
| NjIF Ganë | - | - | - | 1 | - |
| NjIF Finlandë | - | - | - | - | 1 |
| NjIF Norvegji | - | - | - | - | 2 |
| Agjensionet ndërkombëtare të zbatimit të ligjit | - | - | 5 | 3 | - |
| Gjithsej | 13 | 6 | 20 | 18 | 14 |

Tabela nr.27– Përgjigje në Kërkesat e huaja të shpërndara nga NJIF-K 2012-2016

5.2.1.2. Kërkesat e NJIF-K drejtuar FIU ndërkombëtare për shkëmbim të informacionit ndërkombëtar

Duke mos qenë anëtar i EgmontGroup, natyrisht që është përcjell me disa vështirësi rreth shkëmbimit ndërkombëtar të informatave, kjo jo që ka hasur në rezistencë nga vendet e ndryshme, por që është ndërlidhur më tepër rreth përdorimit të kanaleve të sigurta të komunikimit, ku një gjë të tillë e mundëson ESW⁵. Pavarësisht kësaj, NJIF-K ka përdorë kanalet më të sigurta të mundshme të komunikimit duke përdorur opsionet që ofron goAML. Megjithatë do të bëhen përpjekje maksimale për anëtarësim në EgmontGroupme qëllim të krijimit të portave, mekanizmave apo kanaleve të qarta dhe efektive që do të lehtësojnë dhe të lejojnë shkëmbime të shpejta dhe konstruktive të informacionit të drejtpërdrejtë mes homologëve.

⁵Web-i i Sigurt i Egmont



NJIF-K duke analizuar raste në proces mund të hasë në transaksione të atilla që kërkohet edhe informacioni nga vende tjera, për të cilat NJIF-K mund t'ju drejtohet me kërkesë për informacion homologëve të huaj varësisht nga rasti. Falë bashkëpunimit të ndërtuar me NJIF ndërkombëtare, ky informacion në shumicën e rasteve është i qasshëm nga ana e NJIF-K.

Të dhënat e prezantuara më poshtë tregojnë se NJIF-K bashkëpunimin e saj e shtrin edhe përtej vendeve të regjionit.

| Kërkesat e NJIF-K për FIU tjera homologe | 2014 | 2015 | 2016 |
|--|-----------|-----------|-----------|
| NjIF Austri | 1 | 0 | 0 |
| NjIF Bosnje dhe Hercegovinë | 1 | 0 | 0 |
| NjIF Britani e Madhe | 0 | 1 | 0 |
| NjIF Ganë | 0 | 1 | 0 |
| NjIF Gjermani | 4 | 2 | 2 |
| NjIF Greqi | 0 | 1 | 0 |
| NjIF Holandë | 1 | 0 | 1 |
| NjIF Itali | 3 | 1 | 0 |
| NjIF Mali i Zi | 0 | 3 | 0 |
| NjIF Maqedoni | 1 | 0 | 4 |
| NjIF Qipro | 1 | 1 | 0 |
| NjIF Shqipëri | 6 | 3 | 1 |
| NjIF Suedi | 1 | 0 | 1 |
| NjIF Turqi | 4 | 3 | 1 |
| NjIF Ukrainë | 2 | 0 | 0 |
| NjIF Zvicër | 0 | 1 | 1 |
| NjIF Bullgari | 0 | 0 | 1 |
| NjIF Arabi Saudite | 0 | 1 | 1 |
| Gjithsej | 25 | 18 | 13 |


Tabela nr.28 – Kërkesat e NJIF-K drejtuar NJIF tjera homologe 2014-2016



5.2.1.3. Shkëmbimi në kohë dhe konstruktiv i informacionit

Numri i ditëve mesatare për kthimin e përgjigjeve ndërkombëtare ka shënuar rënie të theksuar në vitin 2016, gjë që konsiderohet progres në trajtimin e kërkesave të tilla për shkëmbim ndërkombëtar të informacionit. Për këtë qëllim, NJIF-K i kushton vëmendje të veçantë kërkesave të huaja dhe është duke bërë përpjekje për ekzekutimin në mënyrë efikase të kërkesave ndërkombëtare në kohë të duhur dhe pa vonesa të paarsyeshme.

Në këtë kontekst, koha mesatare për kthimin e përgjigjeve në vitin 2016, ka qenë 16 ditë, i cili numër është më i vogli në pesë vitet e fundit.




Grafiku Nr.15 - Numri mesatar i ditëve për t'iu përgjigjur kërkesave të huaja

5.2.1.4. Ndarja Spontane e Informacionit me FIU Ndërkombëtare

Përveç shkëmbimit të kërkesave ndërkombëtar, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parave, NJIF-K ka vazhduar si aktivitet përmes shpërndarjes së raporteve spontane, duke përcjell 11 raporte spontane për dyshimet e hasura gjatë analizave të rasteve në proces. Informacionin i shkëmbyer në mes homologëve nuk përdoret si provë por vetëm në mënyrë të autorizuar dhe për qëllime inteligjence.


Legjislacioni në fushën e PPP/LFT i jep kompetencë NJIF-së që, spontanisht, të këmbejë informata me çdo homolog të huaj që kryen funksione të ngjashme dhe që u nënshtrohet obligimeve të ngjashme për ruajtjen e konfidencialitetit, pavarësisht nga natyra e homologut, dhe brenda kornizës ligjore vendore të secilës palë.

Me qëllim të ofrimit të një gamë të gjerë të mundshme të bashkëpunimit ndërkombëtar, NJIF-K gjatë vitit 2016, ka ndarë me njësitë homologe të huaja gjithsej 11 raporte spontane të inteligjencës, të cilat janë shpërndarë me qëllim të analizimit dhe hetimit të mëtutjeshëm tek FIU nga vende të ndryshme. Kjo tregon për një ngritje gjithnjë e më shumë të shpërndarjes së raporteve të tilla të inteligjencës.



Grafiku nr.16 - Informacioni Spontan i shpërndarë nga NJIF-K 2013-2016

Raporti mes informacionit spontan të shpërndarë dhe atij të pranuar është 85% në favor të informacionit të shpërndarë nga NJIF-K në krahasim me 15% ndaj atij të pranuar.



Grafiku nr.17–Informacioni Spontan i shpërndarë nga NJIF-K 2013-2016

| Informacioni Spontan i shpërndarë nga NJIF-K | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|--|----------|----------|----------|-----------|
| NjIF Shqipëri | - | - | 3 | 1 |
| NjIF Britani e Madhe | - | - | 1 | - |
| NjIF Bullgari | - | - | - | 1 |
| NjIF Bjellorusi | - | 1 | - | - |
| NjIF Francë | - | - | - | 1 |
| NjIF Holandë | - | - | - | 1 |
| NjIFItali | - | - | - | 1 |
| NjIF Lituani | - | 1 | - | - |
| NjIF Poloni | - | 1 | - | - |
| NjIF Maqedoni | 1 | 1 | 2 | 4 |
| NjIFQipro | - | 1 | - | - |
| NjIF Gjermani | - | 1 | - | 1 |
| NjIF Luksemburg | 1 | - | - | - |
| NjIFMali i Zi | 1 | - | 1 | - |
| NjIF Rumani | - | - | - | 1 |
| NjIF Suedi | - | - | 1 | - |
| Gjithsej | 3 | 6 | 8 | 11 |

Tabela nr.29 –Informacioni Spontan i shpërndarë nga NJIF-K 2013-2016

5.2.2. Bashkëpunimi regional

Në vitin 2016, një delegacion i FIU nga Shqipëria i udhëhequr nga Drejtori i saj kanë vizituar NJIF-K. Qëllim i vizitës ishte diskutimi mbi çështjet me interes të përbashkët në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, shkëmbimit të informacionit mes dy njësive, rreziqet me të cilat vendet tona përballen në fushën e PPP/LFT, rritja e kapaciteteve profesionale dhe teknike si dhe përcaktimi i fushave të bashkëpunimit në këtë drejtim, ecuria e anëtarësimit të NJIF-K në organizmat ndërkombëtare, etj.

5.2.3. Memorandumet e Mirëkuptimit

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes NJIF-K dhe njësisë homologe nga Lituania në tetor 2016, përbën marrëveshjen e pesëmbëdhjetë (15) të bashkëpunimit të nënshkruar në sferën ndërkombëtare.

NJIF-K parasheh që të fuqizohet edhe më tutje bashkëpunimi ndërkombëtar me FIU të shteteve tjera. Objektivi i NJIF-K është që të ndërtojë marrëdhënie bashkëpunimi dhe të lidhë marrëveshje mirëkuptimi me sa më shumë shtete sa i përket këmbimit të informacioneve që lidhen me shpëlarjen e parave apo financimin e terrorizmit.

Pavarësisht kësaj, Ligjit për PPP/LFT i lejon ligjërisht NJIF-K të ndajë informacion spontan ose sipas kërkesës me FIU tjera ndërkombëtare. Për më tepër, me qëllim të krijimit të procedurave për shkëmbimin e informacionit dhe ngritjes së bashkëpunimit, ligji në fjalë ia mundëson NJIF-K të lidh marrëveshje me një agjenci homologe të huaj e cila kryen funksione të ngjashme dhe i nënshtrohet obligimeve të ngjashme për ruajtjen e fshehtësisë.

| Memorandumet e Mirëkuptimit me NJIF ndërkombëtare | | | |
|---|------|-------------------|------|
| Juridiksioni | Viti | Juridiksioni | Viti |
| Shqipëri (DPPPP) | 2009 | Finlandë (NjJIF) | 2013 |
| Maqedoni (MLPD) | 2009 | Poloni (GIIF) | 2014 |
| Mali I Zi (APML) | 2009 | Shqipëri (DPPPP)* | 2014 |
| San Marino (FIA) | 2009 | Hungari (HFIU) | 2015 |
| Slloveni (OMLP) | 2009 | Maqedoni (FIO)* | 2015 |
| Kroaci (AMLO) | 2010 | Ganë (FIC) | 2015 |
| Turqi (MASAK) | 2012 | Lituania (FNNT) | 2016 |
| Republika Çeke (FAU-CR) | 2012 | | |

*Ripërtirje

Tabela nr.30 - Memorandumet e Mirëkuptimit me NJIF ndërkombëtare

5.2.4. Procesi i Anëtarësimit në organizata ndërkombëtare

5.2.4.1. *Grupi Egmont*

Procesi i anëtarësimit të NJIF-K në Grupin Egmontka vazhduar edhe gjatë vitit 2016. Në muajin shkurt është mbajtur takimi i Grupit Egmont dhe grupeve punuese në MonteCarlo, Monako. Edhe në këto takime, ka mbetur rekomandim që Kosova duhet t'i bëjë ndryshimet ligjore, me qëllim të pjesa ligjore të jetë në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe Kosova të vazhdoj rrugën e anëtarësimit në Egmont. Për më tepër është vendosur që procesi duhet të vazhdohet



dhe Sponsorët e NJIF-K duhet t'i rifreskojnë raportet e kërkuara⁶ sipas procedurës për antarësim.


Për këtë qëllim, janë bërë përpjekjet maksimale nga NJIF-K dhe autoritetet tjera në Kosovës që të plotësohen të gjitha kushtet për antarësim të kërkuara nga grupet punuese të Egmont. Është miratuar Ligji i ri për PPP/LFT dhe është shënuar progres në këtë drejtim.

Pjesëmarrja në grupet punuese të Grupit Egmont për qëllim të antarësimit të NJIF-K, është planifikuar të realizohet gjatë muajit korrik (17-22 korrik 2016), por për shkak të sulmeve terroriste dhe ngjarjeve të ndodhura në Istanbul, takimi Plenar i Grupit Egmont është anuluar. NJIF-K mbetet në kontakt me sekretariatit e Egmontit dhe Sponsorët e NJIF-K. Në këtë takim plenar përveç tjerash ka qenë e planifikuar edhe shqyrtimi i antarësimit të NJIF Kosovë në këtë organizatë ndërkombëtare. NJIF-K ka pranuar ftesën për pjesëmarrje në këtë takim Plenar i planifikuar të mbahet në Istanbul të Turqisë.

Për më tepër, në dhjetor 2016, Drejtori i NJIF-K ka pranuar ftesën e sekretariatit të Egmont për pjesëmarrje në takimet e kësaj organizate që është planifikuar të mbahet nga 29 janar – 3 shkurt 2017 në Doha, Katar. Në këtë takim te Egmontit pritet shqyrtimi i kandidaturës së NJIF-K për pranim në Egmont.

NJIF-K ka planifikuar që në takimin Plenar të Egmont të ketë vizita dhe takime me homologet ndërkombëtar për qëllime të PPP/LFT si dhe të diskutohet edhe nënshkrimi i MM me NJIF tjera ndërkombëtare.

⁶ *Raporti i Vlerësimit në Teren, Formulari me Kritere për Antarësim dhe Pyetësi për Antarësim në Grupin Egmont/ On-Site Assessment Report, Membership Criteria Template dhe Egmont Group Membership Questionnaire*



6. MENAXHIMI I RREZIKUT NË PASTRIM TË PARAVE DHE FINANCIM TË TERRORIZMIT

6.1. *Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit 2014-2018*

NJIF-K ka vazhduar me zbatimin në praktikë të implementimit të planeve të saj strategjike duke veçuar edhe Strategjinë Kombëtare dhe Planit të Veprimit të Republikës së Kosovës për Parandalim dhe Luftim të Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018. Janë bërë raportimet e rregullta periodike, është fokusuar në rishikimin e Planit të Veprimit dhe realizimit të aktiviteteve që dalin nga vlerësimi i rrezikut sektorial për kompanitë e ndërtimit.

Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit përbëjnë një mekanizëm të menaxhimit të rrezikut kombëtar nga fenomenet e dëmshme të trajtuara nga kjo strategji. Si mbështetje e kësaj strategjie janë krijuar edhe mekanizmat për hartimin, rishikimin, miratimin, implementimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të veprimit 2014-2018.

Strategjia ishte hartuar bazuar në të gjeturat e raportit të vlerësimit të rrezikut kombëtar ku janë identifikuar gjashtë objektiva kryesore. Plani i Veprimit të Strategjisë Kombëtare 2014-2018 përbën një udhërrëfyes që duhet të përcjellët në mënyrë që të përmbushen aktivitetet dhe objektivat strategjike. Ky Plani i Veprimit pritet të rishikohet për t'u plotësuar me të gjeturat e vlerësimit të rrezikut sektorial.

NJIF-K është një nga institucioneve kyçe për sa i përket implementimit të kësaj Strategjie dhe Planit të veprimit, për të cilën është autoriteti përgjegjës në lidhje me përmbushjen e shtatë (7) veprimeve të përcaktuara në planin e veprimit, përdërisa institucion mbështetës ishte i përfshirë në gjithsej njëzetedy (22) aktivitete. Me qëllim të përmbushjes së planit të veprimit dhe arritjes së objektivave strategjike, gjatë vitit 2016 janë ndërmarrë veprimet si në vijim:

- ka vazhduar zbatimin i aktiviteteve mbikëqyrëse të pajtueshmërisë për të vlerësuar PPP/LFT duke raportuar pajtueshmërinë e subjekteve me ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit,
- Janë hartuar aktet nënligjore për organizimin e brendshëm të NJIF-K-së për të pasqyruar detyrat dhe kërkesat e reja të njësisë të parashikuara me ligj duke u bazuar në ambientin e tij funksionues,
- është bërë ndryshimi i Procedurave Standarde Operative për aktivitetet e mbikëqyrjes së pajtueshmërisë të NJIF-K duke i përshtatur me ligjin e ri të miratuar,
- ka vazhduar përpjekja për anëtarësim të NJIF-K-së në Grupin Egmont të Njësisë të Inteligjencës Financiare për të rritur shkëmbimin ndërkombëtar të inteligjencës financiare dhe për të zhvilluar parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi,
- është bërë sigurimi i bashkëpunimit operativ të NJIF-K-së me NJIF-të e huaja përkatëse përmes nënshkrimit të Memorandumeve të Mirëkuptimit me njësinë homologe nga Lituania.

Vlerësimi i rrezikut sektorial për sektorët tjerë, është planifikuar të realizohet në kuadër të projektit të ri të BE-së, përfituese e të cilit projekt është NJIF-K. Ky projekt pritet të filloj në vitin

2017. Po ashtu do të bëhen përpjekje për anëtarësim në rrjetin e FIU-ve rajonale dhe do të jetë aktive në nismat rajonale.



7. MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE

7.1. Projektet e financuar nga BE-ja&KiE

7.1.1. Projekti i BE&KiE “Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë - Faza II (PECK II)”

Më 1 janar 2016 ka filluar së implementuariprojekti i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë PECK II⁷”. Kohëzgjatja e projektit pritet të jetë 36 muaj.

Këshilli i Evropës, për disa vite, e ka mbështetur NJIF-K përmes aktiviteteve të bashkëpunimit teknik që janë përqendruar në mbështetjen e hartimit legjislativ, trajnimit dhe këshillimit të politikave. Kjo ka përfshirë, legjislacionin kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, trajnimin për përdorimin e mjeteve speciale të hetimit, hetimet financiare, dhe masa të tjera kundër krimit të organizuar dhe pastrimit të parave. Më herët, ndërmjet viteve 2012 dhe 2015, projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK I) ka prodhuar, në dy cikle të njëpasnjëshme, vlerësimin e parë gjithëpërfshirës dhe të strukturuar të pajtueshmërisë së Kosovës me standardet evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e luftimit të pastrimit të parave e financimit të terrorizmit (LPP/LFT).

Faza e dytë e projektit PECK (PECK II) bazohet në rezultatet dhe mësimet e nxjerra nga faza e parë dhe ka për qëllim që të mbështesë reformat dhe përpjekjet kundër krimit ekonomik me theks të veçantë në masat e ndërlidhura kundër korrupsionit, dhe të kontribuojë në zhvillim të kapaciteteve dhe qëndrueshmërinë e përpjekjeve kundër krimit ekonomik. Kjo do të ndihmojë autoritetet e Kosovës në zbatimin e rekomandimeve specifike nga ciklet e mëparshme të vlerësimit të kryera nga projekti PECK I përmes asistencës teknike të shënjestruar ndërkohë që do të vazhdohet me vlerësimin e strukturuar të kornizave të LKK dhe LPP/LFT përkundrejt standardeve ndërkombëtare në evoluim.

Aktivitetet e asistencës teknike do të mbulojnë të dy komponentët (korrupsionin dhe pastrimin e parave) duke trajtuar aspektet e zhvillimit të kapaciteteve në fushën kundër krimit ekonomik në lidhje me reformat legjislative, institucionale, të politikave dhe operacionale. Forcimi i kapaciteteve për të zbatuar dhe bashkërenduar në mënyrë efektive masat kundër korrupsionit do të ndërlidhet me një riorganizim të mëtejshëm të shkëmbimit të informatave ndërmjet agjencive dhe mekanizmave të bashkëpunimit për të siguruar masa efektive të bashkërenduara kundër krimit ekonomik. Për më tepër, aktivitetet e asistencës teknike do të mbështesin më tej autoritetet e Kosovës për të marrë pjesë më mirë në procesin e vlerësimit të ardhshëm që do të kryhet gjatë vitit të fundit të projektit PECK II⁸.

Aktivitetet e projektit do të përfshijnë vlerësime, dhënie të këshillave/opinioneve nga ekspertë, konferenca, tryeza të rrumbullakëta dhe seminare, punëtori, trajnime dhe hulumtime. Produktet e dorëzueshme dhe rezultatet e projektit do të dokumentohen përmes dokumenteve teknike, manualeve ose produkteve të tjera me shkrim që do të vihen në dispozicion përmes faqes së internetit të projektit.

⁷IPA 2014

⁸ 2018



Njësia për Inteligjencë Financiare dhe Agjencia kundër Korrupsionit janë përfituesit kryesor të këtij projekti dhe do të jenë përgjegjëse për koordinimin e aktiviteteve të projektit në emër të institucioneve të Kosovës. Për më tepër, projekti do të përfshijë përfaqësues të ministrive përkatëse (që mbulojnë fushat e drejtësisë, punët e brendshme, financat dhe administratën publike), institucionet e zbatimit të ligjit, strukturat specifike të qeverisë dhe institucionet qendrore, agjencitë ekzekutive kyçe, sektorin financiar, industrinë dhe shoqërinë civile.

7.1.2. Projekti i KIE&BE "iPROCEEDS"

Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës janë duke implementuar projektin e përbashkët "iPROCEEDS" i cili ka si synim të ardhurat nga krimi kibernetikë duke mbuluar Evropën Jug-Lindore dhe Turqinë.

Njësia për Inteligjencë Financiare është përfitues e këtij projekti, i financuar si pjesë e programit IPA. Projekti iPROCEEDS ka për synim targetimin e aseteve të cilat derivojnë apo gjenerohen nga krimet kibernetike. Shtetet të cilat janë përfituese të këtij projekti janë: Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Shqipëria, Bosnja e Hercegovina dhe Turqia.

Përveç NJIF-K përfitues tjerë në këtë projekt janë edhe institucione tjera si: Policia e Kosovës me Sektorin për Hetimin e Krimeve Kibernetike dhe Hetimet e Integruara Financiare, Prokuroria e Shtetit, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Ministria e Drejtësisë – Departamenti për bashkëpunim ndërkombëtar. Për më tepër përfitues të projektit janë edhe sektori privat.

Gjatë vitit 2016, NJIF-K ka marr pjesë në shtatë aktivitete të organizuara nga ky projekt.

7.2. Mbështetja nga UNDP

UNDP në partneritet me Departamentin e Drejtësisë të Ambasadës Amerikane OPDAT, nga data 8-10 nëntor në Prizren ka mbajtur dhe organizuar seminarin e parë, nga një sërë trajnimesh dhe aktiviteteve tjera të planifikuara për mbështetjen e ndjekjes së suksesshme të shkeljeve të korrupsionit përmes ndërtimit, rritjes dhe rritjes së kapaciteteve të hetimit financiar. Seminari mbledhi së bashku mbi 50 zyrtarë të institucioneve të ndryshme përfshirë NJIF-in, Policinë dhe Prokurorinë. Zyrtarët dhe hetuesit nga Kosova janë pajisur me njohuri rrethshembujve të ndryshëm të ndjekjeve të suksesshme, nga vendet si Mbretëria e Bashkuar, SHBA dhe Sllovenia, si dhe ushtrime për ngritjen e kapaciteteve për t'i ndihmuar pjesëmarrësit të zhvillojnë strategjitë e hetimit për veprat penale më të shpeshta që kanë të bëjnë me korrupsionin: shpërdorimi i detyrës, ndikimet në tregti, ryshfeti, mashtrimi dhe përvetësimi.

Ekspertët nga FBI, Prokurorët e Departamentit të Drejtësisë së SH.B.A.-së, një hetuesnë detyrë nga Skocia dhe një prokuror i shtetit nga Sllovenia, prezantuan tek pjesëmarrësit teknikat hetimore të rastet që kanë punuar duke nënvizuar studimet rasteve nga gjykimet e korrupsionit, duke përfshirë sfidat me të cilat janë ballafaquar, me qëllim që hetuesit dhe zyrtarët tjerë në Kosovë t'i shmangen grackave gjatë hetimit.

Grupet punuese të përbëra nga prokurorë, hetues policorë, zyrtarë tjerë të zbatimit të ligjit dhe zyrtarë të Njesisë së Inteligjencës Financiare, janë trajnuar rreth zhvillimit të një strategjie të

përbashkët të hetimit financiar, bazuar në veprat më të theksuara të korrupsionit në Kosovë, duke u fokusuar në punën e përbashkët ekipore dhe ndihmës që mund t'i jap njëra tjetrës.

Përveç kësaj, në kuadër të një projekti të përbashkët mes UNDP dhe Ministrisë së Financave, është organizuar një trajnim me stafin e NJIF-K në lidhje me Direktivën e re të BE-së 849/2015 dhe ndryshimet që pritet t'i ketë kjo direktivë në të ardhmen.

Për vitin vijues janë përgatitur trajnime dhe kurse vijuese si pjesë e programit trajnues. Për më tepër UNDP do ta mbështet NJIF-K në hartimin e Tipologjive për PEP si dhe vlerësimet e rrezikut sektorial për sektorët më të cenueshëm në PP/FT.



8. PLANI I PERFORMANCËS DHE RESURSEVE TË NJIF-K 2015-2017

NJIF-K ka vazhduar me implementimin e planit strategjik të saj "Plani i përfomances dhe resurseve të NJIF-K 2015-2017" i cili përshkruan detyrat, misionin, vizionin, qëllimet, objektivat dhe veprimet e Njesisë për Inteligjencën Financiare të Kosovës (NJIF-K) si dhe përmban parashikimin për alokim të resurseve dhe kontroll të brendshëm dhe për të cilat rezultatet e implementimit të planit të përfomances dhe resurseve 2015-2017.

Plani i përfomancës dhe resurseve 2015-2017 përcakton se si NJIF-K do të ndërtoj kapacitetet e saj dhe të arriturat për t'i përmbushur dhe tejkaluar sfidat me të cilat do të ballafaqohet gjatë periudhës tri vjeçare dhe se si do të mirëmbajë pozitën e vet si një ndër njësitë efikase të inteligjencës në Kosovë dhe në rajon. Ky plan gjithashtu tregon se si NJIF-K do të matë suksesin e vet dhe si do të kontrollojë proceset e veta të brendshme.

Plani i Përfomances dhe Resurseve është ndarë në katër kapituj kryesor:

1. Prezantim i detyrave, misionit, vizionit, qëllimeve strategjike dhe organizimit të njesisë si dhe objektivat, planet e veprimit dhe indikatorët e përfomances;
2. Mjedisi Operativ i NJIF-K dhe Vlerësimi i Rrezikut;
3. Objektivat, zyrtarët përgjegjës, planet e veprimit dhe indikatorët e përfomances;
4. Burimet Financiare, njerëzore dhe të Teknologjisë Informative dhe Plani i sigurisë, objektit dhe zyrave të NJIF-K.

Ky dokument strategjik përcakton objektivat që duhet të përmbushen nga NJIF-K. Ai gjithashtu përmban planet se si t'i arrij ato objektiva dhe indikatorët kyç të përfomancës për të matur efikasitetin e njesisë. Janë përcaktuar 6 objektivat kryesore strategjike të NJIF-K për periudhën 2015-2017, të cilat janë paraqitur siç vijon:

1. Objektivi 1 – Rritja e vetëdijesimit dhe komunikimit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit;
2. Objektiva 2 – Promovimi i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe intensifikimi i mbikëqyrjes së pajtueshmërisë;
3. Objektiva 3 – Zhvillimi, standardizimi dhe intensifikimi i proceseve të raportimit, inteligjencës dhe analizave dhe promovimi i bashkëpunimit të agjencioneve për detektimin dhe hetimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit si dhe konfiskimit të të ardhurave nga krimi;
4. Objektiva 4 – Zhvillimi i legjislacionit kombëtar PPP/LFT dhe standardeve të brendshme të NJIF-K dhe sigurimi i implementimit efikas të tyre;
5. Objektiva 5 – Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes proaktive ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit;
6. Objektiva 6 – Rritja e kapacitetit të NJIF-K.

Për më tepër, Plani i Përfomances dhe Resurseve 2015-2017 përmban gjithashtu burimet financiare (buxhetin e NJIF-K), burimet njerëzore, vlerësimin e përfomances dhe ndërtimin e kapaciteteve të personelit të NJIF-K, teknologjinë informative dhe hapësirën punuese.



Pas rishikimit të këtij plani strategjik dhe pasi është bërë vlerësimi për përmbushjen e objektivave dhe aktiviteteve të parapara në atë plan strategjikë ka rezultuar se ka pasur aktivitete si në vijim:

- Është mbështetë Ministria e Financave dhe sekretariati në përpilimin e raporteve mbi situatën për pastrimin e parasë, financimin e terrorizmit dhe krimet tjera financiare në Kosovë;
- janë ndërmarrë veprime për vlerësimin e rrezikut sektorial në sektorët më të cenueshëm, duke përfshirë termat e referencës së projektit të BE që pritet të filloj në vitin vijues,
- janë fuqizuar edhe më tej masat parandaluese të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit;
- është bërë ngritja e vetëdijesimit dhe komunikimit për luftën kundër pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit përmes konferencave, trajnimeve dhe seminareve të organizuara me sektorin publik, privat dhe të tjerët;
- janë lëshuar sanksione administrative efektive, proporcionale dhe bindëse për dështim nga subjektet raportuese të definuar në nenin 16 të ligjit për PPP/LFT, për t'iu përmbajtur obligimeve ligjore të parashikuara në atë ligj;
- ka vazhduar ngritja e bashkëpunimit me institucione të zbatimit të ligjit sa i përket zbulimit dhe hetimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe konfiskimi i të ardhurave të krimit;
- është vazhduar me promovimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet agjencioneve përmes pjesëmarrjes në procedurën kombëtare të targetimit për krime serioze dhe krijimin e ekipeve të përbashkëta hetuese me autoritetet relevante kombëtare siç përcaktohet në procedurat Standarde të Operimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës për Targetim të Krimeve Serioze;
- është bërë zhvillimi i legjislacionit kombëtar PPP/LFT dhe standardeve të brendshme të NJIF-K dhe sigurimi i implementimit efikas të tyre ku gjatë vitit 2016 është bërë miratimi i ligjit të ri për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit;
- është hartuar plani i akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit të NJIF-K që pritet të miratohen në vitet vijuese me qëllim të sigurimit të implementimit efikas të tyre;
- është kryer fizibiliteti për qasje direkt në databazën e doganës;
- është bërë ngritja e kapaciteteve të NJIF-K përmes trajnimeve, seminareve, kurseve dhe konferencave të ndjekura nga stafi i NJIF-K;
- është fuqizuar edhe më tepër bashkëpunimi ndërkombëtar përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me FIU homologe ndërkombëtare;
- janë bërë përpjekjet maksimale për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, duke plotësuar kushtet e kërkuara për anëtarësim;
- është bërë përpjekje të përmirësojë dhe zhvillojë përdorimin e statistikave duke vendosur dhe implementuar Procedurën Standarde të Operimit në statistikën e NJIF-it.



8.1. Grupet Punuese dhe Planet e Veprimit të Strategjive Nacionale

Raporti i gjendjes 2016⁹ për implementimin e Planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018, tregon se është bërë në mënyrë të suksesshme nga njësi duke tejkaluar indikatorët kyç të performances të paraqitur në atë plan të veprimit. NJIF-K ka ndarë detyrat e punës për secilin aktivitet të cilat janë shpërndarë tek zyrtarët kompetent të njesisë, dhe raportimi është bërë në baza të rregullta periodike. Implementimin e objektivave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit të njesisë e monitoron anëtari i sekretariatit të Strategjisë, përdorur raportin e përmbushjes së atyre aktiviteteve e miraton Grupi i Përhershëm Qeveritar.

Për më tepër, kontributi i NJIF-K ka vazhduar në implementimin dhe rishikimin e strategjive kombëtare duke qenë pjesëmarrëse aktive në:

- Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018,
- Strategjinë Kombëtare kundër krimit të organizuar 2012-2017,
- Strategjinë Kombëtare kundër Terrorizmit 2012-2017,
- Strategjinë dhe planin e veprimit për implementimin e strategjisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm,
- Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA),
- Planin Vjetor të Punës së Qeverisë 2016, dhe
- Planin e punës së Ministrisë së Financave për Vitin 2016.

8.2. Objektivat e përcaktuara në Planin Vjetor të Punës së Ministrisë së Financave dhe Programin e Qeverisë

Në Planin Vjetor të Punës së Ministrisë së Financave (PVPMF) për Vitin 2016, janë përcaktuar katër 4 objektiva strategjike, të cilat kanë si synim parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

1. Kompletimi i kornizës ligjore për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit,
2. Fuqizimi i kapaciteteve për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit,
3. Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes pro-aktive karshi bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit,
4. Ndërmarrja e vlerësimit të rrezikut sektorial dhe specifik për fushat përkatëse me fokus në sektorët dhe fushat më të rrezikuara.

Përmbushja e këtyre objektivave është synuar të arrihet përmes shtatëmbëdhjetë (17) aktiviteteve në të cilat NJIF-K është institucion përgjegjës ose mbështetës. Këto aktivitete përmbajnë në vete 26 masa (indikator) legjislative dhe zbatuese. Nga aktivitetet që përmban ky plani i punës, gjatë këtij viti raportues 2016, NJIF-K ka filluar me zbatimin e rreth 94% e planit të punës.

⁹Publikuar në <http://mf.rks-gov.net/>



Programi Qeveritar për vitin 2016 ka përmbajtur 7 aktivitete në të cilat NJIF-K përcaktohet të jetë institucion përgjegjës ose mbështetës. Kryesisht këto aktivitete përfshijnë përmbushjen e obligimeve në lidhje me miratimin e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit që duhet të jetë në harmoni me Direktivën (KE) 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 20 majit 2015 mbi Parandalimin e Përdorimit të Sistemit Financiar për qëllim të Pastrimit të Parave apo Financimit të Terrorizmit, pastaj luftimi i korrupsionit dhe krimet të organizuar si dhe lufta kundër ekonomisë informale, Fuqizimi i mekanizmave për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftimi i terrorizmit.

8.3. Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA)

Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 16 dhjetor 2015, përmes Vendimit nr. 06/64, dhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 10 mars 2016, përmes Vendimit nr. 05-V-246. Si i tillë, PKZMSA është dokument ligjërish i detyrueshëm për të gjitha institucionet e Kosovës. Sipas Programit, secili organ i administratës shtetërore është përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të tij në kuadër të fushëveprimit të kompetencave të tij, respektivisht ashtu siç parashihet në kuadër të matricës së masave afatshkurtra.

NJIF-K si institucion për zbatimin e këtij programi kombëtar, në kuadër të matricës së masave afatshkurtra për vitin 2016, respektivisht zbatimit të nenit 89 të MSA-së, është përfshirë në dy kapituj:

- Kapitulli 4 i acquis-së: Lëvizja e lirë e kapitalit
- Kapitulli 24 i acquis-së: Drejtësia, liria dhe siguria

Në kuadër të këtyre kapitujve, NJIF-K është përcaktuar të jetë institucion përgjegjës ose mbështetës për zbatimin e PKZMSA në gjithsej 9 masa afatshkurtra, nga të cilat 1 është masë legislative, ndërsa 8 prej tyre janë masa zbatuese:

- Tek masat legislative, akti kombëtarë që do të harmonizohet është:
 - Miratimi i Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit.
- Në kuadër të reformave institucionale dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale janë përcaktuar veprimet vijuese:
 - Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve analitike të stafit të NJIF-K për parandalimin e pastrimit të parave, luftimin e financimit të terrorizmit dhe veprave të ndërlydhura penale,
 - Fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve të zbatimit të ligjit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe trajnimi i subjekteve raportuese,
 - Ngritja e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave në mes të NJIF-K dhe institucioneve homologe ndërkombëtare me qëllim të parandalimit dhe zbulimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe veprave të ngjashme penale.
- Si masa zbatuese në praktikë është përfshirë:

- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit të Republikës së Kosovës për Parandalim dhe Luftim të Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018,
- Monitorimi i aktiviteteve në kuadër të Strategjisë Kombëtare dhe Planin e Veprimit të Republikës së Kosovës për Parandalim dhe Luftim të Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018,
- Zbatimi i Planit Vjetor të NJIF-K për Mbikëqyrjen e Pajtushmërisë,
- Sensibilizimi i qytetareve dhe bizneseve për deklarimin e mjeteve monetare. Në këtë masë NJIF-K është institucion mbështetës,
- Të dëshmojnë rezultate konkrete në fushën e luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Me qëllim të përmbushjes së këtij programi kombëtar, NJIF-K ka raportuar rregullisht në baza periodike si dhe ka marrë pjesë në takimet e rregullta të Nën-Komiteteve për Drejtësi, Liri dhe Siguri. Sa i përket shkallës së zbatimit, të gjeturat tregojnë se në përgjithësi, në lidhje me zbatimin e masave nga NJIF-K nuk ka vonesa serioze dhe masat e planifikuara janë realizuar brenda afatit të paraparë.

8.4. Sfidat për të ardhmen në përmbushjen e planit të performances dhe strategjive tjera kombëtare

Sfidë për të ardhmen në përmbushjen e planit të performances mbetet:

- Nxjerrja e akteve të reja nënligjore të nevojshme për zbatimin e ligjit për PPP/PFT,
- Ndërmarrja e vlerësimit të rrezikut sektorial dhe specifik për fushat përkatëse me fokus në sektorët dhe fushat më të rrezikuara,
- Vlerësimi i rrezikut Kombëtar të PP/FT,
- Ngritja edhe më tutje e vetëdijesimit dhe komunikimit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit,
- Promovimi i mëtutjeshëm i bashkëpunimit ndër-agjenci për zbulimin dhe hetimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit si dhe me fokus të veçantë në konfiskimin e të ardhurave nga krimi,
- Harmonizimi i statistikave dhe informatave kthyesë në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit,
- Përmbushja e aktiviteteve që dalin nga zbatimi i Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së,
- Anëtarësimi i NJIF-K në Egmont Grup,
- Sigurimi i hapësirave punuese të përshtatshme të NJIF-K e cila do të përmbushte kërkesat e sigurisë dhe hapësirës së nevojshme punuese,
- Rritjen e kapaciteteve të NJIF-K me personel të ri dhe Modernizimi i Infrastrukturës së TIK-ut.





Rr. EduardLir Nr.1 – Arbëri – Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 38 247 105 – Fax: +381 38 247 103

<http://fiu.rks-gov.net>

fic@fic-ks.org